



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 05 / Maj 2025

Devotshmëria
Busulla e besimtarit



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al


Viti XXXIV i botimit

Nr. 05 (504)


Maj, 2025

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al



editorial

- 04** Të festosh përtej sakrificës
Mehmet Disha

në fokus

- 06** Fjalim i mbajtur në konferencën ndërkombëtare
në Abu Dhabi / H. Bujar Spahiu

lajme / aktivitete

- 08** 01-Zhvillohet faza e parë e konkursit rajonal të Kuranit Famëlartë
02-Një delegacion akademik ndërkombëtar viziton Komunitetin Mysliman të Shqipërisë
03-Kryetari i KMSH-së merr pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga universiteti "Mohammed Bin Zayed" në Abu Dhabi
04-Zhvillohet edicioni i katërt i konkursit ndërkombëtar "Urtësitë e Traditës Profetike"
05-Vizitë pune në myftininë Dibër
06-Zhvillohet panairi shkencor në Medresenë e Tiranës

refleksione

- 14** Pasuria, xhiahadi dhe shpëtimi ynë
Haki Sahitaj

çështje fetare

- 16** Ndjekja e një medhhebi
Këshilli për Çështjet Fetare – insi.al

familja

- 20** Parimet e Edukimit Profetik (3): "Tregohuni tolerantë!
Armand Asllani

horizonti i besimit

- 22** Pyetje - përgjigje për gratë rreth namazit
Fatma Karaj
24 Njerëzit si Ebreheja janë gjithmonë të humbur
Tauland Bica
28 Respekt dhe vlerësim, jo bullizim
Leonard Çela
30 Devotshmëria, busulla e besimtarit
Anis Qafa

bota shpirtërore

- 32** Parime Profetike në zgjidhjen e problemeve sociale / Abdullah Bulku

hapësirë femënore

- 36** Stinët e jetës
Ilir Kadia

këndi i poezisë

- 38** Pse Zoti s'na pranon lutjet?
Shejh Ibrahim Ed'hem



Të festosh përtej sakrificës



Kurban Bajrami është festa që simbolizon, midis të tjerave, sakrificën sublime të njeriut të përsosur, me emrin e së cilës janë të lidhur ngjarje madhore që kanë ndryshuar rrjedhën e historisë, si: rindërtimi i Qabes, haxhi, emërtimi "mysliman" etj.

Me emrin e kësaj feste lidhet edhe kulmi i bindjes, i besnikërisë dhe i dashurisë ndaj Allahut të plotfuqishëm nga ana e profetit Ibrahim a.s., i cili u sinjalizua nga Zoti që të flijojë djalin e tij të vetëm, Ismailin. Besimi i madh ndaj Allahut bëri që Ibrahim të jetë plotësisht i gatshëm për të kryer pa mëdyshje këtë frymëzim hyjnor, pavarësisht se sprova ishte e rëndë në mënyrë të skajshme: përballimin e kulmit të dhembjes fizike nga Ismaili që, megjithëse në një moshë të njomë, për dëshirën e Zotit, u tregua i gatshëm të flijojë jetën e vet dhe, nga ana tjetër, të dhembjes shpirtërore nga ana e Ibrahimit, që ishte në moshën e thellë të pleqërisë. Por qëllimi hyjnor është fisnik. Kur Allahu pa bindjen dhe përkushtimin e lartë të profetit Ibrahim urdhëroi fljimin e një dashi.

Kuptimi i flisë dhe i sakrificës në Islam, nuk qëndron në derdhjen e gjakut të një kafshe, por në aktin e bindjes. I Plotfuqishmi thotë: "Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre (kurbaneve- kafshëve të therura), por tek Ai arrin bindja juaj..." (Haxh, 37)

Te Zoti fjalët dhe klithmat nuk kanë peshë. Ato çka Ai vlerëson janë punët dhe veprat e mira. Por edhe këto duhet të bëhen me sinqeritet e të jenë të pastra nga hipokrizia dhe egoizmi. Nuk është veprimi ynë i jashtëm i flisë që ka vlerë, por është mbytja e shtazërisë në shpirtin tonë, është thyerja dhe shporrja e zakoneve të liga nga sjelljet tona, është vënia e vetes në shërbim të së vërtetës kur dhe ku të jetë nevoja. Kjo është ajo që e do dhe e mbron Islami, ky është mësimi që jep e duhet të na japë ky akt, therja e kurbanit.

Por, ç'është qëllimi shoqëror dhe njerëzor i festës së Kurban Bajramit dhe si duhet të jetë edukata apo morali gjatë kohës së tij?

Qëllimi shoqëror i Bajramit është të mbjellë harenë në zemra, gëzimin në shpirta, qetësinë e trupave, përforcimin e dashurisë shoqërore, mëshirën mes të afërmeve dhe bashkëpunimin e ndërsjellë njerëzor.

Në këtë festë afrohen zemrat, bashkohen me lidhje miqësore, harrohen

urrejtjet, takohen pas ndarjes, pajtohen pas mosmarrëveshjeve, shtrijnë dorën e pajtimit, përkatësisht ripërtërihen lidhjet shoqërore e njerëzore me dashuri, sinqeritet e vëllazërim.

Qëllimi shoqëror i festës është rikujtimi i anëtarëve të shoqërisë për të dobët dhe të paftët, derisa çdo shtëpi dhe familje të mbushet me gëzim e hare. Këtë qëllim të lartë shoqëror e simbolizon urdhërimi i Sadakatul -fitrit në festën e Bajramit të Fitrit dhe i prerjes së kurbaneve në festën e Kurbanit të Bajramit...

Qëllimi njerëzor i festës është shoqërimi i një numri të madh njerëzish në gëzim e hare, në një kohë të caktuar, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Kështu njerëzit ndiejnë lumturi të përbashkët, kurse fëmijët e një populli, pa marrë parasysh shtëpitë e shpërndara, bashkohen në shijimin dhe në përkujtimin e begative të Allahut. Në festë forcohen lidhjet ideologjike e shpirtërore që i caktoi feja për njerëzit, pa marrë parasysh llojllojshmërinë e gjuhëve dhe kombeve....

Shoqëri e lumtur konsiderohet ajo që e lartëson deri në kulm moralin dhe ndjenjën njerëzore gjatë kohës së festës, sepse në këtë kohë ajo tregon bashkimin, kooperimin dhe mëshirën e ndërsjellë të saj, derisa çdo zemër mbushet me dashuri, mirësi e kënaqësi dhe çdokush ia tregon hallet vëllait të vet në rast të katastrofave ose ngjarjeve tragjike, qoftë edhe në vende të tjera.

Sa njerëz ka që janë të zhytur në varfëri të thellë e për shkak të mbrojtjes së nderit dhe dinjitetit nuk kërkojnë lëmoshë! Ata përjetojnë mjerim gjatë ditëve të festës, një mjerim jo të zakonshëm... Ne ndoshta i harrojmë, mirëpo njerëz të tillë kemi plot afër nesh, qoftë me lidhje familjare, shoqërore apo fqinjësore; kjo harresë nuk bën pjesë në shoqërinë e lumtur...

Prandaj, le ta tregojmë veten të vetëdijshëm gjatë festave tona dhe ta ndiejmë atë që është pjesë e ndjenjave të njerëzve të tjerë! Le ta pakësojmë dëfrimin dhe teprimin e t'ia ofrojmë atyre që kanë nevojë. Le të ndiejmë lidhje të fuqishme vëllazërore gjatë ditëve të festës, ashtu që katastrofat që i përjetojnë vëllezërit tanë të na nxisin në dhënie e sakrifikim!

Le të kufizojmë qeshjet tona dhe mbi fytyra të na ndrisë nuri i pikëllimit të sinqertë!...



Fjalim i mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare në Abu Dhabi



Të nderuar të pranishëm,
Për mua është një nder i madh të jem i pranishëm në këtë takim konsultativ të rëndësishëm në këtë vend të nderuar.

Ky takim vjen në një situatë ku bota është mbushur me konflikte fetare dhe ideologjike, që zhvillohen nën peshën e urrejtjeve të trashëguara ndër dekada, madje edhe shekuj.

Përballë kësaj vale me përmasa të mëdha pasojash negative për brezat që do të na pasojnë, del në pah nevoja urgjente për rigjallërimin e vlerave të bashkëpunimit të frytshëm ndërmjet vetë myslimanëve, si dhe për bashkëjetesën paqësore mes feve dhe kulturave.

Harmonia nuk është një zgjedhje dekorimi kozmetik, por është një nevojë e domosdoshme për mbijetesën e njeriut dhe stabilitetin e shoqërive.

Feja jonë madhështore islame, me metodikën e saj Kur'anore dhe Profetike, nuk

mjaftohet vetëm me thirrjen drejt tolerancës, por ndihmon në krijimin e një praktike konkrete dhe edukon ndjekësit e saj rreth domosdoshmërisë së eliminimit të urrejtjeve dhe mostrashëgimitin e tyre tek brezat pasardhës.

Për këtë arsye, mund të shohim se si çdo shikim dhe intuitë e paanshme është drejtuar me mendje dhe me zemër drejt këtij qyteti të madh, Abu Dhabi, kryeqytetit të sigurisë dhe paqes, nga ku u lançua edhe Dokumenti i Vëllazërisë Njerëzore (i firmosur nga imami Ahmed Tajib dhe Papa Françesku, më 4 shkurt, 2019).

Nuk ka dyshim se ajo ngjarje e madhe nuk ishte për ne thjesht një mundësi për turizëm, dhe as për të konkurruar për të dalë para kamerave, por ishte një mundësi për ta jetuar atë mendim me shpirt, mendje dhe punë, duke pasuar metodën e Mësuesit më të madh, Profetit tonë të dashur Muhammed

(paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe pasuesve të tij të nderuar.

Për këtë arsye, ky amanet, më i madhi që kemi mbi supe, kërkon nga të gjithë ne që të jemi të përkushtuar ndaj këtyre përpjekjeve madhore dhe të përkryera, për të qenë në nivelin e këtij vizioni që bazohet në Islam dhe zhvillimin që duhet të përhapet në mbarë botën.

Të nderuar vëllezër,

Bashkëjetesa mes feve nuk do të thotë asnjëherë shkrirje, por do të thotë pranim i ekzistencës së tjetrit dhe trajtim i tij me nder dhe drejtësi si një partner i denjë në njerëzoren dhe jo si armik.

Siç thotë Allahu i Lartmadhëruar:

"Allahu nuk ju ndalon të silleni me mirësi dhe me drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë suaj dhe që nuk ju dëbuan nga vendi juaj."

Për këtë arsye, unë dëshiroj me gjithë zemër, madje lutem që të dalim nga ky takim me një moto të madhe: "Sot e tutje nuk ka më vend për urrejtje në zemrat dhe jetët tona."

Ne e kemi provuar shijen e hidhur e urrejtjes për dekada të gjata dhe të dhimbshme, dhe ka ardhur koha që këto urrejtje të ndalen tek ne dhe të mos u transmetohen atyre që vijnë pas nesh.

Në historinë tonë të ndritur ka dëshmi të panumërta, nga të cilat po ju përmend disa:

Së pari, në Taif: pas keqtrajtimit dhe goditjes së Tij me gurë, Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) iu lut Allahut ta udhëzonte atë popullit dhe jo të hakmerrej.

Ai tha: **"Përkundrazi, shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre njerëz që do ta adhurojnë Allahun".**

Ky është një qëndrim që tregon një vizion për të ardhmen, të pajisur me mëshirë, që nuk zvarritet pas së kaluarës dhe nuk zhytet në urrejtje.

Së dyti, në Mekë: Pas çlirimit të saj, Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) iu drejtua atyre që e kishin përndjekur dhe torturuar, si atë vetë, ashtu edhe shokët e tij, dhe u tha:

"Çfarë mendoni se do të bëj me ju?"

Ata u përgjigjën: **"Ti je një vëlla fisnik, bir i një vëllai fisnik."**

Profeti u tha: **"Shkoni, jeni të lirë."**

Me këtë akt faljeje, ai mbylli kapitullin e së kaluarës dhe hodhi themelet për një shoqëri të re – të lirë nga hakmarrja, urrejtja dhe armiqësitë.

Së treti, Ali bin Ebi Talib (Allahu qoftë i

kënaqur me të): në letrën e tij drejtuar njërit prej strategëve të tij më të suksesshëm, Malik el-Eshter, vendosi një rregull të artë:

"Njerëzit janë dy llojesh: ose vëlla i yti në fe, ose i barabartë me ty në krijim."

Kështu ai bëri që lidhja njerëzore të jetë baza e mëshirës dhe drejtësisë.

Kështu kanë qenë edhe të parët tanë të mirë, të dalluar për trimërinë dhe mençurinë e tyre. Ata e kuptuan se urrejtja e trashëguar është një rrezik për brezat, prandaj e kapërcyen atë dhe u larguan prej saj duke kërkuar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.

O ju vëllezër të nderuar,

Le të jetë detyra jonë sot që t'i edukojmë fëmijët tanë të bazuar mbi udhëzimin e kësaj rruge dhe dritave të saj dhe mbi shembullin e të parëve tanë të mirë që e ndoqën atë, jo mbi errësirën e tregimeve që nxisin hakmarrje gjakatare dhe ndezin zjarrin e urrejtjes.

Ne duhet t'u mësojmë brezave të rinj se fitorja jonë e vërtetë nuk qëndron në hakmarrje, por në kapërcimin e dhimbjes dhe në ndërtimin e një bote ku mbretëron mëshira dhe respekti i ndërsjellë.



01 ZHVILLOHET FAZA E PARË E KONKURSIT RAJONAL TË KURANIT FAMELARTË



Për të dytin vit radhazi, Ministria e Çështjeve Fetare e Arabisë Saudite në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri, organizojnë konkursin rajonal të Kuranit famëlartë, këtë herë në Prishtinë.

Nisur nga kjo, në datat 8, 9 dhe 10 Prill, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, zhvilloi fazën paraprake me synimin për të përzgjedhur 10 djem dhe 10 vajza, të cilët do të marrin pjesë në garat finale ndërkombëtare.

Thirrjes së KMSH-së për pjesëmarrje në këtë konkurs ju përgjigjën rreth 70 konkurrentë të grupmoshave 12 deri në 30 vjeç, kriter ky i vendosur më parë nga organizatorët.

Juria e këtij konkursi i zhvilloi seancat vlerësuese në Tiranë dhe në Shkodër, ku sipas rivajetit Hafs nga Asim, u shpallën 20 fitues që do të përfaqësojnë Shqipërinë në fazën finale.

Faza finale, që do të zhvillohet në datat 1-5 maj në Prishtinë, do të organizohet në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës, Ministrinë e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite dhe Ambasadën Saudite në Shqipëri.

Theksojmë këtu se Shqipëria, në kuadër të marrëdhënieve mjaft të konsoliduara që ka me Ministrinë e Çështjeve Fetare në Mbretërinë e Arabisë Saudite, ka numrin më të madh të konkurrentëve nga i gjithë Ballkani dhe Evropa Juglindore.



02 NJË DELEGACION AKADEMIK NDËRKOMBËTAR VIZITË NË KMSH



Një delegacion ndërkombëtar akademikësh zhvilloi dhe një vizitë në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ku u prit nga kryetari H. Bujar Spahiu dhe bashkëpunëtorët e tij.

Delegacioni ndodhet në Shqipëri në kuadër të një programi Erasmus+ me temë: "Përballja me Sfidat Globale: Edukimi për Mjedisin dhe Paqen nëpërmjet Bashkëpunimit Ndërfetar në Trajnimin e Mësuesve të Fesë", një bashkëpunim akademik midis Universitetit Bedër dhe universiteteve prestigjioze nga Gjermania, Austria, Spanja dhe Malajzia.

Aktiviteti bashkon studiues, pedagogë dhe përfaqësues komunitetesh fetare nga vende të ndryshme, me qëllim forcimin e bashkëpunimit akademik dhe rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore dhe të paqes nëpërmjet edukimit dhe arsimit.

Pas takimit me kryetarin Spahiu, i cili e njohu delegacionin me rolin e KMSH-së gjatë një shekulli për kontributin e tij në paqen sociale dhe ruajtjen e vlerave universale, islame dhe kombëtare për një shoqëri të shëndetshme, delegacioni ka vijuar me disa sesione pune të projektit Erasmus, zhvilluar në ambientet e KMSH-së, ku pjesëmarrësit diskutuan mbi rolin e universiteteve për edukimin e brezave të rinj me vlerat e përbashkëta për ruajtjen e mjedisit dhe ekologjisë.

Ky takim i nivelit të lartë vjen si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për të integruar vlerat ndërfetare dhe edukimin për qëndrueshmëri në politikat dhe praktikat arsimore në Europë dhe më gjerë.



03 KRYETARI I KMSH-SË MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE TË ORGANIZUAR NGA UNIVERSITETI "MOHAMMED BIN ZAYED" NË ABU DHABI



Universiteti "Mohammed Bin Zayed" në Abu Dhabi organizoi konferencën shkencore me temë "Shtetësia, Identiteti dhe Vlerat e Përbashkëta të Bashkëjetesës", një ngjarje e rëndësishme akademike dhe ndërfaqetare që mbledhi personalitete të njohura nga bota akademike, fetare dhe institucionale nga mbarë bota për të reflektuar mbi sfidat dhe mundësitë e bashkëjetesës në shoqëritë moderne.

Në këtë konferencë mori pjesë me ftesë zyrtare nga Universiteti "Mohammed Bin Zayed" edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili ishte moderator i sesionit me temë "Respektimi i Diversitetit: Vlerat e Njohjes dhe Pranimit", si dhe mbajti referimin e tij mbi rolin e shtetësisë dhe identitetit në ndërtimin e bashkëjetesës sociale dhe paqes ndërfaqetare.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu theksoi se "shtetësia nuk është vetëm një dokument apo lidhje ligjore, por një vetëdije e thellë për përkatësinë dhe një angazhim i ndërgjegjshëm ndaj përgjegjësisë shoqërore." Ai shtoi se identiteti nuk është një gjendje statike, por një proces ndërveprimi i vazhdueshëm mes kulturës dhe hapjes, ndërsa pluralizmi nuk është kërcënim për unitetin, por pasuri për shoqërinë.

Gjatë qëndrimit në Abu Dhabi, Kryetari i KMSH-së zhvilloi edhe takime dypalëshe me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve akademike, fetare dhe qeveritare, pjesëmarrës në konferencë, duke diskutuar për mundësi bashkëpunimi dhe shkëmbime në fushën e arsimit, dialogut ndërfaqetare dhe nismave të tjera.

Konferenca, e zhvilluar më 15 dhe 16 Prill 2025, përfshiu diskutime mbi temat kyçe si shtetësia dhe përkatësia në botën moderne, dialogu ndërkulturor, si dhe sfidat dhe mundësitë e bashkëjetesës në shoqëritë multikulturore.



04 ZHVILLOHET EDICIONI I KATËRT I KONKURSIONIT NDËRKOMBËTAR “URTËSITË E TRADITËS PROFETIKE”



Në një atmosferë të ngrohtë akademike dhe shpirtërore, Kolegji Universitar Bedër organizoi edicionin e katërt të konkursit ndërkombëtar “Urtësitë e Traditës Profetike”, një aktivitet i rëndësishëm që solli në qendër të vëmendjes modelin profetik si frymëzim për brezin e ri.

Me pjesëmarrjen e mbi 400 nxënësve dhe studentëve nga shkolla 9-vjeçare, gjimnaze dhe universitete, si dhe me konkurrentë nga vende të ndryshme si Kosova, Maqedonia e Veriut, Italia, Luksemburgu, Kirgistani dhe Nigeria, ky konkurs dëshmoi vlerën ndërkombëtare që përçon mesazhi i traditës profetike.

Ekspozita me projekte dhe postera të përgatitur nga pjesëmarrësit shpalosi kreativitetin dhe përkushtimin e të rinjve për të eksploruar dhe përcjellë vlerat universale të profetit Muhamed (a.s), duke bashkuar dimensionin shkencor me atë shpirtëror.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Rektori i Kolegjit Universitar Bedër, Prof. Dr. Gjergji Sinani, theksoi rëndësinë e nismave që nxisin të rinjtë drejt dijes dhe virtytit.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, i cili në fjalën e tij përshëndetëse theksoi: “Punimet tuaja të përmbledhura nën emërtimin ‘Urtësitë e Traditës Profetike’ janë më shumë sesa një kërkim akademik. Ato janë një ftesë për reflektim mbi thesarin e çmuar që qëndron në fjalët dhe veprimet e Profetit Muhamed (a.s).”

Aktiviteti u pasurua me lexim të Kuranit Famëlartë, poezi, interpretime të ilahive dhe performanca artistike.



05 VIZITË PUNE NË MYFTININË DIBËR



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me nënkryetarin e institucionit, z. Taulant Bica dhe anëtarë të tjerë të kryesisë, zhvilluan një vizitë pune në Myftininë e Dibrës, ku u pritën nga myftiu, z. Muis Kurtulla, administratori dhe imamët përkatës.

Ashtu si edhe në myftinitë e tjera të vendit, kjo vizitë kishte si qëllim monitorimin dhe vëzhgimin në terren të objektivave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme lidhur me planin strategjik të punës për periudhën 2024-2029.

Në fjalën e tij hapëse, Myftiu i Dibrës, z. Kurtulla, bëri një përmbledhje të punës së Myftinisë, duke vënë theksin te angazhimi intensiv i imamëve gjatë Ramazanit. Më tej, ai u ndal në problematikën e emigrimit dhe pasojat që ka sjellë kjo e fundit në jetën fetare dhe atë sociale të zonës, gjendjen ekonomike të imamëve, menaxhimin dhe kthimin në efikasitet të plotë të pronave vakëf, si dhe nevojën për investime të qëndrueshme.

Ndërkohë, kryetari Spahiu, përgëzoi imamët për kontributin e tyre të vyer dhe nënvizoi rëndësinë e misionit të tyre si kumtues të fesë islame bazuar në mësimet e Kuranit Famëlartë dhe traditës Profetike. Ai u ndal gjithashtu në çështje të tjera, si anëtarësimet vjetore, investimet e mëtejshme, gjenerimi i të ardhurave nga vakëfet, përmirësimi i kushteve ekonomike për imamët, etj.

Ndërsa nënkryetari Bica, fillimisht falenderoi imamët për përkushtimin e tyre të vazhdueshëm, që nga qyteti deri në fshatrat më të thella të Dibrës. Për të vijuar më tej me përfshirjen e të rinjve në jetën fetare të qytetit, duke theksuar në këtë aspekt rolin dhe misionin e Forumit Rinor Mysliman Shqiptar dhe Institutit të Studimeve Islame "H. Sabri Koçi".



06 ZHVILLOHET PANAIRI SHKENCOR NË MEDRESENË E TIRANËS



Medreseja e Tiranës zhvilloi panairin shkencor 2025, panair ky i cili solli në jetë dijet teorike të nxënësve nëpërmjet projekteve inovative dhe eksperimenteve shkencore.

Përpos mësuesve, prindërve dhe të ftuarve të ndryshëm nga shkolla të tjera 9-vjeçare të Kryeqytetit, të pranishëm në këtë evenimet ishin gjithashtu Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiut dhe Drejtori i Arsimit në KMSH, z. Elton Karaj.

Gjatë këtij panairi, nxënësit e Medresesë patën mundësinë të paraqesin projektet e tyre shkencore, duke demonstruar përkushtimin, pasionin dhe aftësitë e fituara në mësimdhënie.

Projektet e sjella nga ata shtriheshin në fusha të ndryshme të shkencës, si fizika, kimia, teknologjia, biologjia dhe matematika, duke e kthyer ambientin e Medresesë në një qendër të gjallë të dijes dhe inovacionit.

Ky panair është kthyer tashmë në traditë dhe synon të nxisë kreativitetin, mendimin kritik dhe zbatimin praktik të njohurive nga ana e nxënësve.



Pasuria, xhihadi dhe shpëtimi ynë

إِذَا تَبَايَعْتُمْ بِالْعِينَةِ وَأَخَذْتُمْ أَذْنَابَ الْبَقَرِ وَرَضِيتُمْ بِالزَّرْعِ وَتَرَكْتُمُ الْجِهَادَ سَلَّطَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ ذُلًّا لَا يَنْزِعُهُ حَتَّى تَرْجِعُوا إِلَى دِينِكُمْ

“Nëse ju e lini xhihadin dhe e përkushtoni jetën tuaj vetëm për të kërkuar pasuri në rrugë të paligjshme (bi'l-ineh), me mendjen veç pas bagëtive e pas bujqësisë, do të bie një poshtërim mbi ju, dhe do të jetë aq i rëndë, sa që nuk do të mund të shpëtoni nga ai poshtërim deri në momentin kur do të ktheheni tek feja juaj.”

(Ebu Davud, Buju 54; Ahmed Ibn Hanbel, Musned 2/42, 84)

Kur një besimtar i përkushtohet vetëm kënaqësive të jetës dhe dëshirave trupore, duke lënë pas betejën e shenjtë të jetës, ai do të humbasë nderin dhe dinjitetin e tij dhe do të bëhet i poshtëruar dhe i shkatërruar. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Kur një popull lë pas xhihadin, Allahu do të dërgojë një mundim të përgjithshëm dhe një fatkeqësi për të gjithë.” Prandaj, të jetosh me nder dhe dinjitet mund të arrihet vetëm përmes durimit për disa vështirësi të lidhura me xhihadin. Shoqëria duhet të bashkohet dhe të pranojë këto vështirësi, për të fituar të drejtën të jetojë me nder. Por, nëse individët heqin dorë nga xhihadi dhe përqendrohen vetëm në jetën e tyre personale, atëherë do të vijë dënimi i përgjithshëm i Allahut, i cili do t'i mbulojë të gjithë, duke përfshirë të pafajshmit dhe të dhunuarit, dhe duke përfshirë edhe ata që janë të padrejtë. Pra, për të shmangur një fatkeqësi të përgjithshme, është e domosdoshme që të gjithë të angazhohen në xhihad.

Pjesa e parë e përmendur në hadith është “tregtia ine”. Kjo lloj tregtie është shpjeguar në dy mënyra: e para është blerja e një malli me pagesë të vonuar (me borxh) dhe më pas shitja e të njëjtit mall të njëjtit person për një çmim më të ulët dhe me pagesë të menjëhershme (kesh). Qëllimi i kësaj tregtie është ky: personi ka nevojë

për para të menjëhershme, dhe pasi marrja e parasë me kthim më të madh konsiderohet kamatë, ai i drejtohet një rruge të tillë. Zbatimi praktik i kësaj është si vijon: Le të themi se dikush ka nevojë për 800 euro; ai blen një mall që i përket dikujt tjetër për 1.000 euro me pagesë të vonuar. Pastaj ia shet të njëjtin mall dikujt për 800 euro me para në dorë. Një marrëveshje që nga jashtë duket si tregti normale, në thelb nuk ndryshon nga kamata dhe është absolutisht e ndaluar.¹

Interpretimi i dytë i tregtisë ine është si vijon: Ine nënkupton aplikimin e diferencës së afatit të pagesës (shtesë për shkak të vonesës). Për shembull, borxhliu vjen dhe thotë se nuk do të mund ta paguajë borxhin e këtij muaji. Menjëherë i shtohet një afat i ri pagese dhe në të njëjtën kohë i rritet edhe shuma e borxhit si pasojë e këtij vonimi. Të dyja këto veprime, nga këndvështrimi islam, nuk janë të drejta.

I Dërguari i Allahut, në këtë hadith të bekuar, vë në dukje amoralitetin që ndodh mes njerëzve në emër të tregtisë dhe marrëdhënieve financiare, nga fshati më i largët deri në qytetet më të mëdha. Dhe thotë: kur ky

1. Ajo që fshihet pas kësaj, dhe që ngjanë me kamatën është fakti se, ndonëse ti ke nevojë për 800 euro borxh, në fund ti i kthen 1000 pas një kohe (shënim i përkthyesit).

amoralitet t'ju robërojë, atëherë prisni poshtërimin.

Sa i përket çështjes së dytë të përmendur në hadith, që me një përkthim literal do të thotë "kur të kapeni pas bishtit të lopëve dhe të harroni çdo gjë tjetër përveç bujqësisë" nuk ka për qëllim të kritikojë vetë bujqësinë. Sepse i Dërguari i Allahut ka thënë: "Edhe nëse do të ndodhë kiameti, mbillen fidanin që keni në dorë." Për më tepër, Islami nuk e pranon një tokë të vdekur (të pa punuar). Ajo që kritikohet këtu është mungesa e ekuilibrit; sepse nëse prodhimi, që është damari kryesor i jetës ekonomike, kufizohet vetëm në bujqësi, ndërsa tregtia dhe industria neglizhohen, atëherë kemi të bëjmë me një çekuilibër në prodhim. Në të njëjtën mënyrë, edhe përpjekjet për zhvillim që fokusohen vetëm në tregti ose vetëm në industri janë po ashtu shprehje e një çekuilibri. Prandaj, ajo që është thelbësore është që çdo fushë të vlerësohet siç duhet dhe në këtë mënyrë të sigurohet balanca e duhur në prodhim.

Bujqësia zhvillohet në fshatra; prandaj, nëse njerëzit ia kushtojnë veten tërësisht bujqësisë, kjo do të thotë ndalim i plotë i urbanizimit. Ndalimi i urbanizimit do të thotë vdekja e industrisë dhe tregtisë. E kundërta, pra që të gjithë të lënë arat në fshat dhe të dynden drejt qyteteve të mëdha, do të shkaktonte një problem tjetër. Siç shihet sot, zgjerimi i shpejtë i qyteteve, në përpjesëtim me shpejtësinë e rritjes, do të sjellë probleme të reja, do të pengojë shërbimet nëntokësore dhe mbitokësore, dhe papunësia do të arrijë nivele shumë të larta.

Nëse zhvillimi nuk është i balancuar dhe një pjesë e jetës ekonomike vazhdon të mbetet e varur nga jashtë, nuk duhet harruar kurrë se nga ajo anë mund të vijë gjithmonë një goditje. Ashtu siç janë kërcënim për jetën ekonomike mallrat tregtare dhe ndërmarrjet industriale të varura nga jashtë, edhe produktet bujqësore të varura nga jashtë përbëjnë një rrezik. Prandaj, thelbësore është që të ruhet balanca në të gjitha fushat.

Në kohën e Pejgamberit, duke qenë se nuk kishte problem të urbanizimit të shpejtë, pasiguria ekonomike shprehej në hadith si një formë e shfrytëzimit të jetës në bujqësi. Ndërkohë, sot, urbanizimi i shpejtë, me vështirësitë që sjell, është gjithashtu një shenjë e pasigurisë. Çështja e kthimit në fshat ose vendosjes në fshat si një zgjidhje për këtë problem është një nga çështjet që duhet marrë seriozisht, dhe mund të kuptohet edhe nga hadithi në këtë kuptim.

Nga ana tjetër, kthimi në jetë fshati pas qytetërimit ose ngulmi në jetë sa më të thjeshtë është gjithashtu një nga çështjet që kritikohet në hadith. Të gjitha këto sjellin poshtërim dhe varfëri.

Një çështje tjetër e përmendur në hadith është: "Kur të lini përpjekjet në rrugën e Zotit (xhihad)", pra kur të keni humbur angazhimin dhe keni rënë në gjendjen e rehatisë, duke u mbyllur në punët tuaja dhe duke u mbërthyer në to, një poshtërim është gati për ju në fund. Ashtu siç errësohet qielli paranesh, po ashtu edhe jeta

shpirtërore bëhet e tillë, dhe yjet e qiellit tuaj shpirtëror janë shpërbërë. Hëna dhe dielli gjithnjë e më shumë shkojnë drejtë një pike eklipsi. Të jesh musliman me këtë gjendje s'ka fare kuptim të vazhdosësh të jetosh.

Edhe kur do dëshironit të ktheheni përsëri në fe ashtu siç duhet, madje edhe nëse luteni vazhdimisht dhe kërkoni me lot, poshtërimi që jeni duke përjetuar nuk do të hiqet nga koka juaj nga ana e Allahut.

Si do të ndodhi kthimi në fe? Ne mbajmë mbi shpatullat tona të drejtat që ndër shekuj janë mbartur e ruajtur. Por t'i lëmë këto, ne nuk arrijmë dot të mbrojmë siç duhet as të drejtat për vetën tonë. Për më tepër, nuk kemi mundur të përmbushim ato që familja jonë, populli ynë dhe pasardhësit tanë presin prej nesh. Një barrë e rëndë është ngarkuar mbi supet tona, mbi belin tonë të hollë, dhe ne e ndiejmë këtë barrë. Muslimani i shekullit të njëzetë e një është i shqetësuar nën këtë peshë, dhe kjo çështje nuk është e lehtë, përkundrazi, është shumë e vështirë. Sepse përballë jemi me një britmë të shkatërrimit që ka zgjatur tre shekuj, dhe është e pamundur që kjo britmë të ndalet pa vuajtur dhe pa u munduar për një çerek shekulli. Fajtor për këtë gjendje jemi vetëm ne vetë. Prandaj, shpëtimi do të vijë përsëri nga ne vetë. Do t'i shtrëngojmë dhëmbët, do të mbajmë qëndrimin tonë dhe do të drejtohem drejt ndihmës së Allahut, dhe do ta bëjmë këtë jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra. Nëse arrijmë ta bëjmë këtë, dyert e mëshirës do të hapen për ne, dora e mëshirës do të na nxjerrë nga kjo gjendje dhe do të na çojë në brigjet e shpëtimit.

Pejgamberi i Nderuar, sfidonte tërë botën me një xhemat ku çdo individ në të e dinte shumë mirë se çfarë mendonte për çdo pjesë të jetës së tij. Sepse për ta, një jetë pa xhihad do të thoshte një jetë e humbur. Shprehjet e Pejgamberit për këtë çështje janë vërtet mbresëlënëse:

"Kush vdes pa bërë asnjëherë përpjekje dhe sakrificë (xhihad) në jetën e tij, ka vdekur me një dyshim të hipokrizisë dhe ka lënë këtë botë duke dorëzuar shpirtin e tij në terrenin e munafikllëkut." Në një tjetër transmetim thuhet: "Kush del para Allahut pa pasur asnjë veprim të xhihadt në jetën e tij, do të thotë se ka dalë pa asgjë, i zbrazur." Kjo do të thotë, ky individ ka ardhur para Gjykatës së Madhe me një gjendje që do ta turpëronte dhe skuqte para Zotit të Madhëruar.

Në të djathtën e në të majtë, ka qark shumë njerëz që po vuajnë, që po shtypen nga dhuna dhe po lotojnë gjak nga dhimbjet. Ashtu siç është detyrë për ne të vrapojmë në ndihmë të të përndjekurve, gjithashtu është detyrë për ne të kundërshtojmë padrejtësinë e tiranëve. Ndryshe, do të shkojmë në prani të Zotit të gjithësisë me një simfoni kaq të hidhur, ku ritmet dhe tingujt që dalin do të jenë vajtimet e të munduarve, britmat e grave të dhunuara dhe ngashërimet e fëmijëve jetimë. Të paraqitesh para Zotit me këtë boshllëk dhe këto mangësi, duke ecur me këtë hidhërim dhe përvuajtje, është një fatkeqësi e madhe për ne!

NDJEKJA E NJË MEDHHEBI

Në fushën e fikhut me fjalën medhheb nuk nënkuptojmë individë, por shkollë juridike. Patjetër që mendimi ka lindur prej një individi, por me kalimin e kohës është zgjeruar, duke u kthyer në pasurinë e përbashkët të bashkësisë së gjerë myslimane. Emërtimet e këtyre shkollave me emrat e themeluesve nuk nënkuptojnë sektarizëm, por një konceptim juridik të fesë, i cili herë pas here përditësohet sipas nevojës. Prandaj dhe opinionet juridike të konfirmuara (mufta bih) nuk emërtohen me emra të përveçëm si p.sh., “sipas mendimit të Shafiut”, por thuhet “sipas Medhhebit Shafi”. Kjo do të thotë që në shkollën juridike shafite, pasi janë rrahur mendimet e ndryshme nga juristët e mëdhenj, është arritur në një opinion final në lidhje me një çështje të caktuar. Ky nuk është patjetër opinioni i Imam Shafiut, por është konkluzioni i Shkollës Juridike Shafite.

Kërkimi i opinionit më të drejtë juridiko-fetar ka lindur që në kohën e Profetit (a.s). Kur i Dërguari i Allahut (s.a.s) dërgoi Muadh b. Xhebelin (r.a) si guvernator në Jemen, e pyeti atë: Kur të të paraqitet një çështje si do ta gjykosh? Ai tha: Me Librin e Allahut. Po nëse nuk e gjen aty zgjidhjen? – pyeti Profeti (a.s). Muadhi (r.a) tha: Sipas Sunetit të Rasulullahut (a.s). Profeti (a.s) vijoi: Po nëse nuk e gjen dot as aty? – Do të bëj ixhtihadin tim por nuk e lë pa zgjidhje, – tha Muadhi (r.a).

“Do të bëj ixhtihadin tim” do të thotë që do të bëj përpjekjen time intelektuale, me tërë njohuritë e mia fetare dhe të përgjithshme për të arritur tek gjykimi i drejtë islam. Shkurt, ixhtihadi është “përpjekja që bën gjykatësi dhe drejtuesi për të marrë vendimin e duhur” (Buhari, l’tisam 13, 21; Muslim, Akdije 15; Ebu Daud, Akdije 11; Tirmidhi, Ahkam 3). Përtej detajeve, në literaturën juridike islame tashmë thuhet që juristi bën ixhtihad, ai që bën ixhtihad quhet muxhtehid dhe opinionin final i muxhtehidit quhet hukm (dispozitë) ose fetva (opinion juridik). Për tu quajtur muxhtehid nevojitet formim dhe aftësi të veçanta, gjë që të bën kompetent për të bërë ixhtihad. Prandaj jo çdokush mund të arrijë të bëhet muxhtehid, pavarësisht se kalon edhe tërë jetën duke studiuar fikh.

Në vijim të hadithit të mësipërm, i kënaqur nga kjo përgjigje, Profeti (a.s) i ra në kraharor Muadhit (r.a) dhe tha: “Falënderimi i takon Allahut, i Cili bëri që i dërguari i të Dërguarit të Allahut të ndajë të njëjtin mendim me të Dërguarin e Allahut (s.a.s), me një punë që e kënaq të Dërguarin të Allahut (s.a.s)” (Ebu Daud, IV/3592; Tirmidhi, II/343). Këtu nisi kërkimi për gjykimin e saktë juridiko-fetar, duke analizuar Kuranin dhe Sunetin, si dhe rreth çështjeve për të cilat s’ka tekst hyjnor. Më e rëndësishmja, i gjithë ky aktivitet kryhet në mungesë të Profetit (s.a.s), sepse Muadhi (r.a) do të gjykonte, do të merrte vendime dhe do t’i zbatonte ato, pa pasur mundësinë që të konsultohet me autoritetin e vetëm, Profetin Muhamed (a.s). Kjo ngjarje tregoi që intelekti

njerëzor i individëve kompetentë, mund të arrijë në vendimin e duhur juridiko-fetar, pa harruar faktin që e ka për detyrë ta bëjë dhe ta zbatojë atë.

Dituria në Islam ka patur epoka të ndryshme dhe fusha e fikhut ka arritur pikun e suksesit në shekujt II-III sipas hixhretit. Ky është një proces i natyrshëm dhe i pashmagshëm i zhvillimit të shkencës. Në këto shekuj, disa dijetarë kanë spikatur në fushën e fikhut dhe shumë prej tyre janë kthyer në muxhtehidët e mëdhenj të mbarë myslimanëve. Bëhet fjalë për mbase mbi 80-90 shkolla të tilla juridike. Por me kalimin e kohës shumica e tyre s’ka patur ndjekës dhe nuk i ka rezistuar kohës. Prej tyre, katër medhhebe kanë vijuar të kenë ndjekës dhe t’i përshtaten çdo kohe, duke u përditësuar nga juristët përkatës. Ato janë medhhebet Hanefi, Maliki, Shafi dhe Hanbeli.

Kështu, së pari, medhhebet janë një produkt intelektual, me natyrë dinamike, të testuar ndër shekuj, që kanë provuar se janë të pashmagshëm dhe tepër të nevojshëm. Medhhebet janë rezultat i nevojës dhe jo i divergjencave. Si rrjedhojë, s’mund të mohohet fakti që ekzistojnë dhe që secili prej tyre është në rrugë të drejtë.

Së dyti, qasja e përgjithshme është se çdo mysliman aktualisht e jeton Islamin sipas Kuranit dhe Sunetit. Por ne nuk e mësojmë fenë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga tekstet hyjnore, sepse nuk kemi kualifikimin e duhur për të deduktuar vetë dispozitat e nevojshme për përditshmërinë tonë. Prandaj bazohemi tek “ura” lidhëse mes teksteve fetare (Kurani dhe Suneti) dhe mënyrës së praktikimit të tyre (fikhu); një urë e ndërtuar nga “inxhinierët” më kompetentë, që ka parë historia e myslimanëve. Pikërisht, këto janë medhhebet, që e kanë trajtuar dhe evoluuar mendimin juridik në mënyrë sistematike.

Së treti, myslimani i thjeshtë e merr mendimin fetar nga myftiu, pra personi kompetent për fetvanë. Nëse do ta merrte drejtpërdrejtë nga tekstet fetare, atëherë secili prej nesh do të shpikte një fe më vete. Myftiu është autoriteti që lexon burimet e medhhebit dhe i transmeton mendimin juridik myslimanëve të thjeshtë. Duke qenë se është e pamundur që çdokush të deduktojë fetva në mënyrë të drejtpërdrejtë prej Kuranit dhe Sunetit, qoftë ky myfti, edhe ai shfleton veprat e konsoliduara të fikhut, sipas medhhebit që pason. Prandaj medhhebi është praktika e fesë Islame.

Kështu është formuar një sistem i shëndetshëm për të jetuar Islamin në mënyrë të rregullt dhe pa vështirësi të mëdha për të arritur në dispozitat fetare. Kjo nuk do të thotë që tashmë askush nuk lexon tekstet fetare, pra Kuranin dhe Sunetin, sepse ato janë burimet tona referenciale, por nuk ka më nevojë që të shkohet tek to për çështje tashmë të konsoliduara si p.sh., mënyra e faljes së namazit, sa rekate është namazi i drekës,

kush e ka detyrim zekatin, etj.

A ka çështje për të cilat juristët detyrohen të kthehen në tekstet hyjnore për të gjetur zgjidhje? Patjetër që ka. Bëhet fjalë për çështjet juridike bashkëkohore, të cilat nuk janë trajtuar më parë. Aty, juristi shkon tek Kurani dhe Suneti, si dhe tek opinionet e juristëve të tjerë në çështje të ngjashme.

Tashmë informacioni është shumë i gjerë. Çdokush prej nesh ka nevojë për mendimin e juristëve kompetentë për ta jetuar Islamin. Historia dëshmon se katër shkollat juridike janë themeluar nga personat më kompetentë dhe me dinamizmin që i karakterizon, janë bërë mjeti më efektiv për të jetuar fenë tonë ndër shekuj.

T'i qëndrosh sa më strikt një medhhebi ka rëndësi, sepse gjykimet fetare janë konkluzion i një mendimi juridik të ndërtuar duke zbatuar rregulla të caktuara të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Mendimi juridik hanefi përbëhet nga një tërësi rregullash në harmoni me njëra-tjetrën, të nxjerra prej Kuranit dhe Sunetit, të cilat të orientojnë për të arritur në gjykimin final rreth një çështjeje të caktuar. Po kështu, çdo medhheb ka rregullat e veta të cilat funksionojnë shëndetshëm vetëm nëse zbatohen gjithmonë në tërësi brenda

vetes. Prandaj për të thënë që një çështje e zbaton sipas Medhhebit Hanefi dhe një tjetër sipas Medhhebit Hanbeli, duhet të kesh një pretekst me bazë shkencore. Nëse thua që "kjo më duket më e drejtë dhe më e logjikshme" do të thotë që praktikisht po bën si do vetë. Është e vërtetë që ka raste kur aplikohet mendimi i një tjetër medhhebi, por kjo ndodh vetëm në rast se opinionin juridik i medhhebit që pason, nuk jep zgjidhje apo është i pazbatueshëm. Në këto raste, parimisht, aplikohet mendimi më i afërt i një medhhebi tjetër. Por përzgjedhjen duhet ta bëjë përsëri një person kompetent dhe jo çdo mysliman i thjeshtë. Pra kthehemi përsëri te muxtehidi, dhe në mungesë të tij, te myftiu.

Të eliminosh medhhebin, do të thotë që të eliminosh aspektin praktik të Islamit, që është formësuar nga eksperiencia 14 shekullore e myslimanëve. Në një aspekt, do të thotë që të pretendosh se për rreth 12 shekuj e gjysmë myslimanët kanë gabuar duke ndjekur medhhebe të ndryshme. Por njëkohësisht do të thotë që të refuzosh se qenia njerëzore mund të ketë mendime të ndryshme. Kush pretendoi se ka vetëm një mënyrë se si praktikohet feja, sot e kësaj dite janë përçarë dhe ndarë në grupe të ndryshme.



Sepse lufta me realitetin është e humbur që në krye. Kjo tregoi që nëse njerëzve nuk u ofron një mendim juridik sistematik, pikërisht atëherë do të lindin qindra e mijëra "medhhebe", të cilat s'kanë baza të shëndetshme. Ndërkohë që për anën e zbatimit të një mendimi nuk ka më keq se paqartësia, e cila sjell anarki. Prandaj Zahid el-Keutheri ka thënë se jomedhhebizmi është një rrugë që të shpie në afetari.

Por nëse personi ka formimin e nevojshëm, pra një Kuranin nga fillimi deri në fund, një tërë Sunetin e Profetit (a.s) me transmetime të sakta e të dobëta, një interpretimet e sahabëve, një metodologjinë e fikhut, një interpretimet juridike të juristëve ndër shekuj në mënyrë që të ndajë të drejtën nga e gabuara, atëherë ky person mund ta jetojë Islamin drejtpërdrejt nga Kurani dhe Suneti, sepse është në gradën muxhtehid. Në anën tjetër, nëse ai çalon qoftë tek një prej këtyre, atëherë s'mund të pretendojë panevojshmërinë e ndjekjes së medhhebit. Ndërkohë që thuajse asnjë muxhtehid që ka ardhur pas imamëve të mëdhenj të medhhebeve, nuk ka pretenduar pavarësi prej medhhebit që praktikohej në ambientin ku ai ka jetuar.

Kush nuk e ka formimin e mësipërm, detyrimisht do të ndjekë një person tjetër. Ai "personi tjetër" ose do

të jetë dikush që ka një formim fetar të një farë niveli, që jep mësim në xhami apo në internet, ose do të jetë mendimi juridik i pjekur në 12-13 shekuj. Nëse mendon që i fundit është më i sigurt, atëherë do të thotë që po ndjek një medhheb.

Këtu të lëmë edhe një shënim: Pashmangshmëria e opinionëve të ndryshme të bazuara në Kuran dhe Sunet, është një fenomen real i pamohueshëm shumëshekullor, që ka lindur pas Profetit (a.s). Kështu që edhe pretendimi që "Profeti (a.s) s'ka pasur medhheb, prandaj medhhebet nuk lejohen" është pa sens. Çdo gjë lind sipas nevojës dhe në vijueshmërinë e natyrshme të situatave. Bazuar në faktin që një opinion juridik nuk ëshë i gabuar, na deyrton që atë ta pranojmë si të saktë. Pikërisht kjo mori opinionesh, është kufizuar në "katër" nëpërmjet medhhebeve.

Si konkluzion, gjithsecili prej nesh pason mendimin e një dijetari, që bazohet në Kuran dhe Sunet. Edhe ata që ndjekin medhhebet, edhe ata që e quajnë veten selefi, përsëri pasojnë opinionin juridik të një dijetari, që në një farë mënyre do të thotë një shkollë juridike. Të këmbëngulësh në luftën kundër medhhebit është si të luftosh me çka pashmangmërisht bën vetë.



Parimet e Edukimit Profetik (3): ————— "Tregohuni tolerantë!" —————



Një nga reflektimet e dashurisë dhe dhembshurisë në edukimin, në trajtimin njerëzor dhe marrëdhëniet, me pak fjalë në gjithë jetën është edhe toleranca. Tolerancë është të mos përbuzësh askënd, të mos i fajësosh ata për gabimet e tyre, të mos i poshtërosh, përkundrazi, të mbulosh dhe të falësh gabimet, të përpiqesh të ndërtosh të vërtetat në vend të tyre dhe të sillësh i ekuilibruar kundër njerëzve me besime ose mendime të ndryshme. Toleranca është thelbi i moralit shembullor të të Dërguarit të Allahut (s.a.s). Dhe ky virtut është një traditë profetike e rëndësishme si në arsim dhe edukim ashtu edhe në emër të krijimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve të shëndetshme me shoqërinë në të cilën jetojmë. Është një dinamikë themelore për të prodhuar zgjidhje konstruktive dhe të përhershme për problemet që hasen në foletë familjare, institucionet arsimore dhe në jetën shoqërore. Përndryshe, toleranca do të zëvendësohet nga fanatizmi dhe dhuna, të cilat do të heqin atmosferën e dashurisë, respektit, afeksionit, besimit, paqes dhe qetësisë për të cilat qeniet njerëzore kanë më shumë nevojë.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ekspozoi shembujt më të mirë të tolerancës, e cila është një nga vlerat themelore të Islamit. Në një kohë kur të gjithë ishin të zhytur në armiqësi dhe dhunë për të imponuar mendimin e tyre dhe për të shkatërruar mendimet e të tjerëve, Ai miratoi kuptimin e

tolerancës së Islamit, fenë e dashurisë, dhembshurisë dhe paqes, si një parim në marrëdhëniet njerëzore dhe edukimin dhe e demonstroi atë duke e zbatuar. Si mësues, praktikant e tij në fushën e arsimit dhe urdhrat dhe ndalimet e tij për këtë temë ishin një shembull për të gjithë prindërit dhe mësuesit deri në ditën e kiametit.

Mos përçmoni, toleroni!

Një nga parimet që i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ndoqi në arsimim është parimi i mos përçmimit të askujt, përkundrazi duke iu afruar atyre me tolerancë në emër të edukimit. Kriteri themelor që ai zbatoi dhe rekomandoi në këtë drejtim është: "Një njeriu i mjafton si gjynah që të përçmojë dhe fyejë tjetrin"¹. Sepse, Allahu e krijoi njeriun të çmuar dhe i dha shpirt atij.² Të përbuzësh dhe fyesh atë që Krijuesi i Plotfuqishëm e ka krijuar dhe vlerësuar si krijesë të shenjtë do të thotë t'i nënshtroresh shejtanit. Sepse shejtani, kur u urdhërua nga Allahu që t'i përulet ne sexhde njeriut të parë (Ademit duke pretenduar se Ademi u krijua nga toka), ai u bë kryelartë, e përçmoi atë dhe përfundimisht u rebelua kundër urdhrat të Zotit të tij. Për këtë arsye, u largua nga mëshira e Allahut dhe është i mallkuar deri në ditën e gjykimit.³ Prandaj, ata

1. Muslim, Birr 32; Ebu Davud, Edeb 35; Tirmidhi, Birr 18.

2. Shiko, Isra, 16/70; Hixhr, 15/29.

3. Shiko, Hixhr, 15/30-35.

që e konsiderojnë veten të madh dhe i përçmojnë të tjerët, futen në një rrugë ku kanë për të humbur.

Prandaj, as prindërit, as mësuesit dhe as një udhëzues nuk mund t'u shtojnë vlerë bashkëbiseduesve të tyre duke i nënçmuar, qortuar apo përbuzur. Por duke i respektuar ata, duke dëgjuar idetë dhe mendimet e tyre të ndryshme, duke toleruar gabimet e tyre të vogla e të mëdha dhe duke i bërë ata të ndjehen të vlefshëm me këto sjellje. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk u bëri presion njerëzve me të cilët ishte i angazhuar në edukimin dhe formimin e tyre, ai e shpjegoi mesazhin e tij dhe qëllimin e tij me një gjuhë të butë. Për dhjetë vjet, Enes b. Malik shpreh tolerancën dhe dhembshurinë e tij të thellë si më poshtë:

“Unë i shërbeva të Dërguarit të Allahut për dhjetë vjet. Jo çdo punë e imja shkonte siç dëshironte ai. Por, ai nuk më tha asnjëherë për diçka që e kisha bërë “Pse e bërë këtë kështu?” apo për diçka që nuk e kisha bërë “Pse nuk e bërë atë?”. Ai nuk më qortoi asnjëherë, nuk më kritikoi, nuk u hidhërua me mua dhe as më goditi ndonjëherë. Jo që nuk bëri asnjëherë prej tyre, por as nuk më tha asnjëherë madje as “of”⁴.

Toleroni dhe mbulonit gabimet!

Bashkë me mos shikimin e gabimeve, ajo që kërkon toleranca është edhe mbulimi i gabimeve personale, mëkatet dhe mangësi. Sepse, atyre që gabimet u janë goditur në fytyrën, do të thotë që janë përjashtuar nga arsimimi dhe edukimi. Sepse, askush nuk dëshiron dhe nuk pranon që gabimet dhe mangësitë të zbulohen nga të tjerët. Ata ndiejnë urrejtje dhe armiqësi ndaj atyre që veprojnë kështu me ta. Nëse nëna dhe babai sillen kështu, fëmijët apo të rinjtë ftohen nga prindërit e tyre dhe largohen nga shtëpia, nëse kjo ndodh në shkollë, nxënësit ftohen nga mësuesit dhe largohen nga shkolla. Për këtë arsye, parimi themelor në edukim është jo vetëm tolerimi i gabimeve fëmijëve dhe nxënësit, por duke i mbuluar mangësitë e tyre t'i ndihmojmë ata që t'i rregullojnë gabimet.

Parimi themelor i paraqitur nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.) për këtë çështje është si vijon: “Kushdo që mbulon gjynahun e një vëllai në këtë botë, Allahu do t'ia mbulojë gjynahet atij në botën tjetër”.⁵ Një fëmijë që shikon që gabimet e tij tolerohen dhe mbulohen, do të ndikohet shumë nga kjo sjellje dhe do të ndihet borxhli ndaj prindërve apo mësuesve të tij. Kështu, gabimet që trajtohen me tolerancë gjithashtu çojnë në formimin dhe forcimin e mjedisit të besimit i cili është i domosdoshëm për arsimin. Në të njëjtën kohë, me një veprim të tillë, bashkëbiseduesi mësohet me kulturë e tolerancës dhe mbulimit të gjynaheve. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë: “Person që fsheh gabimet dhe mangësitë e vëllait të tij, është sikur të ketë ringjallur një person të vdekur”⁶.

Këtu janë disa shembuj:

I riu që tallej me Ezanin: Ebu Mahzura

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e njihte natyrën njerëzore dhe iu afrua bashkëbiseduesve të tij me durim, tolerancë dhe mençuri. Le ta dëgjojmë këtë nga Ebu Mahzura, i cili jetoi personalisht:

“Profeti ynë po kthehej nga lufta e Hunejnit. Unë isha gjithashtu me një grup prej dhjetë personash nga Meka. Unë akoma nuk isha bërë mysliman dhe as nuk mendoja se do të bëhesha. Ishte koha për falje dhe myezini filloi të thërrasë ezanin. Unë isha ulur në një cep bashkë me disa të rinj të tjerë, dëgjoja thirrjen e ezanit, e përsërisja atë me sarkazëm dhe duke u tallur. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i cili na pa në atë moment dhe e kuptoi se u tallëm me ezanin për shkak të zërave që bëmë, na thirri pak më vonë dhe na pyeti se cili prej nesh kishte zë më të mirë. Të gjithë shokët e mi më treguan mua. Pas kësaj, ai mi mësoi fjalët dhe më kërkoi të thërrisja ezanin. Megjithëse nuk më pëlqente aspak, duhej të filloja të thërrisja ezanin para tij sepse nuk kisha asnjë alternativë tjetër. Kur mbarova ezanin, ai më dha ca para. Pastaj më puthi në ballë dhe më përkëdheli shpinën. Pas kësaj, unë, i inkurajuar nga afrimi i tij ndaj meje, thashë: “O i Dërguar i Allahut! A do të më lejoni të thërras ezanin në Qabe? Ai tha se më la. Që nga ai moment, zemra ime u mbush me besim dhe dashuri. Unë erdha në Mekë dhe fillova të jem myezin me urdhër të tij.”⁷

Siç mund të shihet në shembullin, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk i tha Ebu Mahzuras, i cili u tall me ezanin dhe u argëtua me të, “Si mund të tallesh me ezanin?” Përkundrazi, ai u soll tolerant ndaj gabimit të tij dhe i kërkon të thërrasë ezanin. Ai gjithashtu e dëgjoji thirrjen deri në fund, i bëri komplimente zërit të tij dhe pastaj e shpërbleu atë. Ndërsa po priste të qortohej apo edhe të ndëshkohej, ai u zbut falë tolerancës, vlerësimit dhe komplimentit që pa dhe filloi ta donte Profetin tonë, të cilin e urrente deri atëherë, dhe u bë mysliman.

Tregohu tolerant me ta, O Omer!

Një nga të afërmit e të Dërguarit të Allahut vdes. Gratë vijnë për të ngushëlluar dhe fillojnë të qajnë. Omeri (r.a) ngrihet dhe përpiqet t'i heshtë e t'i largojë. Pas kësaj, i Dërguari i Allahut tha: “Lëri ata O Omer! Se zemra sapo ka vuajtur nga fatkeqësia, dhimbja është e freskët. Prandaj, sytë mund të derdhin lot. Nuk ka asnjë dëm në këtë”⁸. Përsëri, kur donte të heshte Ummu Sa'd, e cili po qante në varrimin e Sa'd Ibn-i Muaz. Ai i jep përgjigjen vijuese Omerit: “Qetësohu, O Omer! Lëre të qajë. Pas çdo qarje ka një gënjeshtër, përveç të qarës së Ummu Sa'dit. Të gjitha ato që ajo thotë janë të vërteta.”⁹ Siç shihet, në këtë ngjarje, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk tha: “Pse po qan? Ndalo, mos qaj!” etj. Përkundrazi, duke i kujtuar Omerit se dhimbja e tyre ishte e freskët, ai e këshilloi atë që të ishte i butë dhe tolerant ndaj tyre.

4. Ebu Davud, Edeb 1.

5. Muslim, Birr 58, 72

6. Buhari, Mezâlim 3; Ve bkz. Ebu Davud, Edeb 38.

7. Nesai, Ezan 5,6; Ibn Maxhe, Ezan 2.

8. Nesai, (1974); Ibn Maxhe (1576/1587)

9. Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, XV/42483.

Pyetje - përgjigje për gratë rreth namazit

Namazi është një nga shtyllat më themelore të Islamit dhe një ndër format më të rëndësishme të adhurimit ndaj Allahut. Çdo mysliman, mashkull apo femër, që plotëson kushtet e përgjegjësisë fetare, është i obliguar ta falë namazin. Ai është një adhurim që përsëritet në kohë të caktuara, me rregulla të përcaktuara, dhe përmes të cilit besimtari lidhet me Zotin e tij.

Kjo detyrë hyjnore përmendet shpesh në ajetet e Kuranit Famëlartë. Në suren El-Bekare thuhet:

“(Kujtoni) kur Ne morëm besën tuaj: do të adhuronit vetëm Allahun, do të silleshit mirë me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit, do të thonit fjalë të mira njerëzve, do të falnit namazin dhe do të jepnit zekatin.” (El-Bekare: 83)

Ndërsa në suren Junus thuhet:

“Ne i shpallëm Musait dhe vëllait të tij: ‘Ndërtoni për popullin tuaj shtëpi në Egjipt, bëjini ato faltore dhe falni namazin! Dhe jepu lajmin e mirë besimtarëve!’” (Junus: 87)

Namazi është shprehja më e thellë e përlësisë së robit ndaj Zotit. Përmes tij, besimtari përjeton një ndjenjë të veçantë shpirtërore duke dalë përpara Madhërisë Hyjnore pesë herë në ditë. Kjo lidhje e përditshme i forcon besimin, e pastroon shpirtin dhe e bën njeriun më të vetëdijshëm për qëllimin e tij në jetë. Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) ka thënë:

“Gjëja e parë për të cilën do të japë llogari njeriu në Ditën e Gjykimit është namazi.”

Ky hadith na tregon qartë rëndësinë që ka namazi në jetën e çdo myslimani dhe nevojën për përkushtim serioz ndaj tij.

Cilat janë pozicionet e gruas në namaz?

Në disa prej pozicioneve të namazit, gruaja falet ndryshe nga burri, në përputhje me rregullat e ruajtjes së turpits dhe hijeshisë femërore. Më poshtë janë disa dallime:

Pas nijetit, gruaja i ngre duart deri në nivelin e shpatullave dhe merr tekbinin fillestar.

Në qëndrimin në këmbë, i vendos duart mbi gjoks, duke vënë dorën e djathtë mbi të majtën.

Në ruku përkulet lehtë, me kokën pak të ulur dhe me duart mbi gjunjë, pa i shtrirë apo hapur gishtat.

Gjatë sexhdes, i mban krahët afër trupit dhe barkun të mbështetur mbi kofshë.

Në uljen e fundit (teshehhud), nxjerr këmbët në anën e djathtë dhe ulet mbi tokë.

Këto pozicione janë përzgjedhur nga tradita profetike për të ruajtur hijeshinë dhe etiken islame të gruas në namaz. Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) ka thënë:

“Kur gratë të jenë në sexhde, le t’i ulin krahët në tokë, sepse ato nuk janë si burrat.” (Transmeton Jezid b. Ebi Hasib)

A lejohet që gruaja të thërrasë ezanin dhe ikametin?

Sipas medh’hebit hanefi, gruaja nuk e thërret ezanin dhe as ikametin, as për vete dhe as për gra të tjera. Kjo për shkak se ezani dhe ikameti konsiderohen njoftime

publike për faljen e namazit, dhe një shfaqje e tillë publike nuk përputhet me natyrën e hijes dhe turpits që kërkohet prej gruas në Islam. Dijetarët hanefi e kanë cilësuar këtë veprim si të papërshtatshëm dhe mekruh, ndërsa namazi i gruas mbetet i vlefshëm edhe pa ezan e ikamet.

A lejohet të falet gruaja me makijazh ose manikyr?

Nëse makijazhi dhe manikyri nuk pengojnë depërtimin e ujit në lëkurë dhe nuk përmbajnë substanca të papastra (si alkool), atëherë gruaja mund të falet me to.

A mund të lexojë gruaja me zë të lartë në namaz?

Nëse nuk ka pranë ndonjë mashkull të huaj, ajo mund të lexojë me zë të lartë në namazet ku është e lejuar, por kjo nuk duhet të kthehet në zakon.

A lejohet prishja e namazit nëse dikush troket në derë?

Nëse ekziston rreziku për dëmtim në pasuri ose trup, prishja e namazit është e lejueshme, madje mund të konsiderohet e detyrueshme.

A mund të mbajë gruaja fëmijën në krah gjatë namazit?

Nëse është e nevojshme, ajo mund ta mbajë fëmijën në krah, për sa kohë nuk bën lëvizje të shumta që prishin namazin. Profeti (paqja qoftë mbi të) ka vepruar kështu me mbesën e tij Umame

Gruaja dhe namazi në xhami

Sipas medh’hebit hanefi, falja e namazit me xhemat në xhami për gratë nuk është e rekomanduar, sidomos në kohë kur përhapja e shthurjes është e madhe. Megjithatë, nëse shkuarja e gruas në xhami mund të jetë shembull për gratë e tjera dhe ajo i përmbahet rregullave të hijes, atëherë kjo gjë mund të lejohet.

Çfarë kujdesi duhet të tregojë gruaja kur shkon në xhami?

Të vishet me rroba të gjëra dhe të thjeshta.

Të mos përdorë parfum.

Të qëndrojë larg ambienteve ku ka burra dhe të hyjë nga hyrja e veçantë për gra.

Të ruajë qetësinë gjatë qëndrimit në xhami.

A marrin të njëjtin shpërblim gratë si burrat për faljen në xhami?

Po, nëse gruaja falet në xhami me singëritet dhe me kushte të përshtatshme, merr të njëjtin shpërblim. Por për to, namazi i falur në shtëpi mbetet më i vlefshëm.

Si duhet të pozicionohen gratë në xhemat?

Rreshti i grave qëndron pas burrave dhe fëmijëve. Nëse ka vetëm një grua, ajo qëndron pas imamit.

A mund të formojnë gratë një xhemat mes tyre?

Sipas mendimit më të përhapur në medh’hebin hanefi, kjo është e pëlqyer të shmanget. Nëse ndodh, prijësja nuk duhet të qëndrojë përpara, por në mes të rreshtit.

Në përfundim, namazi përbën jo vetëm një obligim fetar, por edhe një burim paqeje e shpirtërie për besimtarin. Për gratë myslimane, njohja e rregullave të sakta dhe respektimi i tyre është mënyra më e mirë për të përjetuar plotësisht bukurinë e këtij adhurimi madhështor.

Njerëzit si Ebreheja janë gjithmonë të humbur

Guvernatori i Jemenit i varur nga mbretëria e Etiopisë kishte filluar përgatitjet për të sunduar gadishullin arabik por edhe për të përhapur fenë e krishterë në ato vende. Shqetësimi kryesor i tij ishin karvanet tregtare të shumta që shkonin në Mekë me qëllim edhe vizitën e Qabes së madhnueshme. Plani i tij ishte që në vend të Mekës, qytetin Sana ta kthente në qendër të vëmendjes tregtare dhe fetare. Ai ishte i vetëdijshëm se Meka këtë rëndësi e merrte nga Qabja. Duke u nisur nga kjo, ai ishte betuar se do të ndërtonte një katedrale shumë të madhe në qytetin e San'a dhe e ndërtoi.¹

Ebreheja kishte menduar çdo detaj dhe kishte bërë çdo kërkim të detajuar në mënyrë që kjo katedrale të zinte vëndin e Qabes. Në këtë plan ai kishte edhe mbështetjen e perandorit Bizantin i cili i kishte dërguar një arkitekt dhe një prift të kualifikuar.

Pas ndërtimit të saj Ebreheja dërgoi lajmëtarë në të katër anët e Jemenit dhe gadishullit arabik për të njoftuar dhe ftuar

1. Ibn-i Sa'd, Tabakât I/90

njerëzit të vizitonin këtë katedrale të madhe.

Populli reagoi shumë keq kundrejt këtij veprimi sepse kishin një lidhje shumë të fortë shpirtërore me Qaben e cila vinte që nga koha e profetit Ibrahim.

Normalisht nuk ishte aq e thjeshtë të çrrënjosësh një besim vetëm me një propagandë dhe urdhër. Reagimi i parë dhe më i ashpër erdhi nga fisi Kinane. Ata jo vetëm që nuk pranuan thirrjen dhe urdhërin e Ebrehes por vranë edhe lajmëtarin e tij.

Faktikisht ka edhe transmetime të tjera në lidhje me shkakun që e bëri Ebrehen të ndërmerre një vendim për prishjen e Qabes.

Një transmetim i Muhatil b. Sulejman thotë se pas urdhërit të Ebrehesë, disa djem nga fisi Kurejsh i Mekes ndezën një zjarr të madh ku u dogj edhe katedralja e sapondërtuar.²

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet se fisi Kinane vrau Muhamed b. Huza'fin i cili ishte dërguar me misjon nga ana Ebrehesë për të përhapur fenë e krishterë.³

2. Ibn Kethir, Tefsîr XV/8659

3. Taberi, Tarih, I/935



Duke u nisur nga kjo kuptojmë se shkaku që e shtyri Ebrehenë të merrte një vendim të tillë mund të ketë qenë jo vetëm fetar por ekonomik dhe politik. Sepse përveç se dëshironte ta kthente qytetin San'a në qendër të vëmendjes fetare, ai synonte që të bëhej epiqendra e gadishullit arabik dhe të siguronte një marrveshje tregtare përmes detit të kuq me Indinë. Dhe kështu ai do të formonte shtetin më të fuqishëm në rajon. Me shembjen e Qabes ai do të merrte drejtimin e Mekes dhe të zonës deri në Siri. Dhe kështu do të bashkohej me Bizantin i cili në atë kohë po luftonte me Persët.⁴

Ushtria e Elefantëve nis drejt Qabes

Ushtria e fuqishme e Ebrehesë tashmë ishte nisur drejt Mekes për të shkatërruar Qaben e rindërtuar nga profeti Ibrahim. Gjatë rrugës ai luftoi dhe mposhti çdo përpjekje të fiseve të ndryshme që tentuan ta pengonin, madje disa prej tyre i detyroi të bashkangjiten ushtrisë së tij. Të njëjtën gjë bëri edhe me fiset arabe pasi arriti në Taif i cili ishte qytet afër Mekes. Duke i

4. Cevad Ali, Mufasssal III/517-519

dhënë atyre siguri se nuk do ti prekte dhe nuk do ti shkatërronte tempullin e idhujtarisë, ai mori dhe mbështetjen e tyre me qenë se e njihnin mirë zonën përreth.

Ushtria i ishte afruar 10 km qytetit të Mekes dhe Ebreheja kishte dhënë urdhër që të mblidheshin të gjitha devetë dhe kafshë të tjera përreth për të siguruar ushqimin e ushtrisë. Ndërkohë nga devetë që morën ishin edhe 200 deve të Abdulmutalibit,⁵ gjyshit të profetit Muhamed (a.s) i cili nuk kishte lindur akoma.

Ebreheja dërgoi një lajmëtarë në Meke për të thënë se nëse nuk kundërshtojnë jeni të sigurt dhe përveç shembjes së Qabes nuk do prekim gjë tjetër. Pasi e dëgjoi Abdulmutalibi thotë se ata nuk kishin fuqi me luftuar kundër Ebrehesë dhe se pronari i Qabes e ruan vetë shtëpinë e vet. Më pas u nis drejt ushtrisë dhe doli përpara Ebrehesë duke i thënë se nuk do të luftonin kundër tyre. Ndërsa për sa i përket Qabes i tha se "Unë nuk jam pronari i saj. Ajo e ka një pronarë dhe Ai e ruan vetë shtëpinë e Tij". Ebreheja u habit me fjalët e Abdulmutalibit, ndoshta duke menduar se qenka

5. Ibn Hisham, Sîre I/48

një lider pa vision dhe që mendon vetëm për pasurinë personale. Kështu që e përcolli atë duke ja kthyer devetë.

Pasi mori devetë dhe u kthye në Mekë, Abdulmutalibi ftoi të gjithë banorët të bënin lutje. Pas mbarimit të lutjes së përbashkët ai i sugjeroi atyre të marrin me vetë çtë munden nga pasuria dhe të tërhiqen nga qyteti drejt maleve më të afërt. Njëra ndër ata ishte edhe nëna e profetit Muhamed (a.s) e cila ishte në muajin e shtatë të shtatëzansisë.

Ushtria e elefantëve po afrohej me ritme të shpejta por në vendin e quajtur Muhasir, elefantët ndaluan papritmas. Nuk po ecnin as edhe një hap drejt qytetit të Mekes. Ushtarët i drejtonin ata për diku tjetër lëviznin por drejt Mekes ishte e pamundur. Kjo i kishte habitur të gjithë. Sikur elefantët donin ti thonin atyre se jeni në rrugë të gabuar.

Ushtria e zogjëve kundër ushtrisë së elefantëve

Pikërisht në këto momente, zogj të shumtë me nga 3 gurë në këmbë dhe sqep vijnë me shpejtësi drejt ushtrisë së Ebrehes dhe i lëshojnë gurët mbi ta sikur të ishin bomba të vërteta. Nuk po kuptonin se cfar ishte duke ndodhur dhe nuk kishin as kohë as vend ku të fshihenin. Tashmë dënimi i Zotit kishte ardhur. Ata që goditenin nga guri ose vdisnin ose nuk ishin në gjëndje të qëndronin në këmbë. Një ndër të paktët që u largua me plagë të rënda ishte edhe Ebreheja. Sikur Zoti donte të jepte

një mësim njerëzve duke mos e vdekur atë në vënd. Ai u kthye ne qytetin San'a i plagosur rëndë dhe me vështirësi të madhe. Pa kaluar shumë kohë vdiq duke u përpëlitur në dhimbje të mëdha. Me dëshirën e madhe për të shembur Qaben dhe për të sunduar gadishullin Arabik, ai i solli fundin vetes dhe perandorisë së tij.

Kjo ngjarje e pazakontë shpjegohet në Kuranin famëlartë ku dhe mban emrin e një sureje: "A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit? A nuk ua bëri përpjekjen e tyre të dështuar? Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë-tufë! Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar! Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!"⁶

Pas kësaj ngjarjeje Kurejshët këtë vit e pranuan si fillim historik dhe e quajtën "Viti i Elefantit".

Mesazhi i ndodhisë së elefantit

Shpjegimi i kësaj ndodhie në një sure duke i dhënë edhe emrin asaj tregon se ka shumë mesazhe dhe mësimë që duhet të nxjerrim nga ajo. Kjo nuk duhet të mbetet thjesht një datë historike në mendjet tona por duhet të nxjerrim mësimet e dhura dhe të përfitojmë mesazhin që Zoti ka dhënë për ne. Disa nga mesazhet e nxjerra nga kjo ndodhi janë:

Doli në pah edhe një herë rëndësia e Qabes tek Allahu dhe rëndësia e saj ju tregua jo vetëm gadishullit arabik por gjithë botës.

Me këtë ngjarje fisit Kurejsh i cili besonte në

6. Surja Fil, 105/1-5

fenë e Ibrahimit a.s iu forcua akoma më shumë respekti ndaj Qabes. Ndërsa atyre që dyshonin i hoqi dyshimet.

Mos pranimi i një alternative tjetër ndaj Qabes që donte të sillte Ebreheja tregon se sa ndikim kishte ajo tek ata njëri. Madje lidhja e tyre me Qaben i ccoi disa nga fiset të sakrifikonin jetën duke e sulmuar Ebrehenë. Kjo ndjenjë tregon sakrificën e tyre për të mbrojtur të shenjtën.

Të luftosh kundër shtëpisë së Allahut do të thotë të luftosh vetë Atë. Askush i cili lufton kundër Tij nuk del fitimtar. Këtë e trgoi Allahu duke mposhtur një ushtri të fortë si ajo e Ebrehesë me një ushtri prej zogjsh të dobët. Dhe ky mesazh do të vazhdoi të kujtohet deri në ditën e fundit.

Përveç një pjese të vogël që ishin në besimin Hanif të Ibrahimit a.s, fisi Kurejsh ishin idhujtarë. Ndërsa Ebreheja dhe ushtria e tij ishin ndjekës të librit prat ë Krishterë. Pra, për nga besimi Ebreheja ishte më i mirë se idhujtarët arabë. Por shkatërrimi i tyre tregon se Allahu e bëri për të mbrojtur shtëpinë e Tij dhe Muhamedin a.s i cili do të lindte 50 dit pas kësaj ngjarjeje. Kjo ndodhi tregon qartë se është një ndër shenjat e profetësisë.⁷

Edhe pse idhujtaria kishte kapluar Mekën, Allahu nuk lejoi Ebrehen të shkatërronte Qaben dhe të sundonte qytetin apo edhe gadishullin arabik. Ndoshta për vetë faktin se me ardhjen e Muhamed mustafasë, Ai dëshironte që Qabja,

7. Ebu'l-Abbas Ahmet İbn Halim, el-Cevabu's-Sahih, 4/122

Meka apo e gjithë zona e Hixhazit të ishte e lire dhe jo e sunduar nga dikushme qëllime përfitimi të kësaj dynjaje por me qëllim që askush të mos pengonte lulëzimin e besimit të pastër dhe moralit. Sigurisht që kjo ishte diccka që asnjë njeri nuk mund ta paramendoi. Sepse i dërguari i tij do të vinte kohë më vonë. Por që kjo mrekulli po pregatiste terrenin për premtimin hyjnor, pra, ardhjen e tij.⁸

Së fundmi mund të themi se ai i cili mron besimtarin nga sulmet e armiqëve është Allahu. Sepse, Ai i cili mbrojti shtëpinë e Tij nga kuthet e armiqëve, e ka më parësore të shpëtoi fenë, profetin dhe besimtarët e Tij. Këtë na e tregon profeti a.s i cili thotë:

“Oj Qabe! Sa e bukur dhe sa aromë të mirë që ke. Sa madhështore që je. Dhe sa respekt të madh meriton të të tregohet. Por betohem në Allahun që ka në dorë jetën e Muhamedit se; reputacioni dhe respekti i besimtarin në prani të Allahut është më i madh se e jotja. Ashtu si duhet të vlerësohet jeta dhe pasuria e tij po ashtu duhet të posedojmë mendime të mira për të”⁹.

Kështu që, Allahu i cili mbron Qaben do të mbroi edhe reputacionin, nderin dhe misionin fetarë të tyre deri ne ditën e fundit. Ai nuk do të lejoi shtypjen e besimtarit të vërtetë i cili simbolizohet me Qaben, kundrejt Neo-Ebreheve të ditëve të sotme.

8. Ebu Faris, es-Siretu'n-Nebeviyye, 113

9. İbn Mace, Fiten 2

RESPEKT DHE VLERËSIM, JO BULLIZIM

Njeriu është krijesë e krijuar nga Krijuesi dhe, ndonëse njeriut i është dhënë vullneti i lirë pjesor brenda vullnetit madhor të Allahut, ky fakt automatikisht e bën njeriun të pafuqishëm për përsa i përket disa zgjedhjeve të rëndësishme për jetën e tij, si për shembull: Ku dhe kur do të vijë në jetë? Fëmijë i kujt do të jetë? Si do të duket në pamjen e jashtme? A do të jetë me shëndet të plotë apo jo? etj.

Ajo çfarë na takon ne si njerëz, është të pranojmë kaderin tonë dhe të përpiqemi të shohim gjërat me pozitivitetin maksimal dhe të shohim miliona arsye që na ftojnë të jemi falenderues ndaj Krijuesit tonë, ku ndërkohë na largojnë pesimizmin për një apo dy gjëra minimale që janë sprovë e kësaj bote kalimtare.

Mjafton fakti që jemi ekzistent, ndaj të cilit si njerëz nuk do të ishim të aftë ta falenderojmë aq sa duhet Zotin e Plotfuqishëm. Nisur nga kjo, Islami na mëson që në të gjitha situatat që përballemi në jetë, duhet të shohim zgjidhjet e dobishme për ne, qoftë se si ti përballojmë sprovat individuale, apo qoftë se si duhet të trajtojmë dikë tjetër që mund të jetë i sprovuar.

Pra, sidoqoftë situata e gjithësecilit në këtë jetë, në një mënyrë apo tjetër ne kalojmë nga një sprovë sidoqoftë ajo, sepse vetë qëllimi i kësaj jetë është sprovë.

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta, e edhe nga frytet, po ti jepu përgëzim durimtarëve!” (Bekara 155)

Nga ky ajet mësojmë se: Jetë pa sprovë nuk ka, por mënyra se si do ta përballosh sprovën është thelbësore për jetën tonë.

A do dalësh me sukses apo jo?! A do fitosh kënaqësinë e Zotit, apo jo?!

Allahu (xh.sh) thotë në vazhdim të këtij ajeti : **“...Të cilëve, kur i godet ndonjë gjë e pakëndshme thonë: “Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!” Të tillët janë, që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë.” (Bekara 156-157)**

Falenderimi dhe durimi është çelsi i suksesit me përballjen e çdo sprove të kësaj jete në aspektin individual. Ndërkohë, empatia dhe ndihmesa, janë çelsi i suksesit që na ndihmojnë në ruajtjen e marrëdhënieve reciproke me respekt dhe vlerësim për çdo qenie njerëzore që na rrethon, pavarësisht situatave të ndryshme të sprovave në të cilat mund të gjendet gjithësecili.

Pavarësisht situatës me të cilën, njeriu përballë nesh, mund të jetë sprovuar, neve na takon që t’u vijmë atyre në ndihmë me aq sa kemi mundësi, duke u përpjekur t’ua lehtësojmë në njëfarë mënyre dhe kurrresi të mos ua vështirësojmë.

“Dara që ndihmon është më e mirë se ajo që ndihmohet” do të thoshte Muhamedi (a.s.), (Buhariu)

Pikërisht, Muhamedi (a.s.) do të tregohej shumë i kujdesshëm në raportet e respektimit të qenies njerëzore, aq sa një herë u çua në këmbë për xhenazen e një besimtari Hebre.

Kur i thanë shokët e tij, se ai është pjestarë i një komuniteti tjetër fetar, ai u përgjigj: **“A nuk është ai krijesë e Allahut (xh.sh)?!”** (Muslimi)

Ndërkohë, kur ky veprim tregon respektin dhe vlerësimin e tij për njerëzit në përgjithësi, ai tregohej shumë i kujdesshëm veçanërisht me njerëzit me aftësi ndryshe. Ai përpiquej që ata t’i bënte pjesë e shoqërisë ku ata jetonin. Pavarësisht se në sytë e njerëzve të tjerë këta ishin persona me aftësi ndryshe, Profeti Muhamed (a.s.) diti shumë mirë të edukojë masën e gjërë mbi këta individë.

Për shembull: Në një rast kur shokët e vunë në lojë Abdullah ibn Mesudin (e bullizuan me termat modernë) për paraqitjen e trupit të tij shtat-shkurtër dhe këmbëve të tij shumë të holla, Muhamedi (a.s.) do t’u thonte: **“Ato këmbë ditën e gjykimit do të peshojnë më rëndë se mali i Uhudit”**, duke u dhënë një mësim të madh të respektimit të njeriut për atë çfarë është në karakterin dhe moralin e tij, dhe kurrresi për pamjen dhe fizikun e tij. (Tabakat)

Muhamedi (a.s.) thotë: **“Allahu nuk shikon fytyrat dhe trupat tuaj, por zemrat dhe punët tuaja”**. (Muslim) Kështu ai poziciononte çdokënd në vendin që meritonte në shoqëri, sepse vlerësimi i njeriut kurrësi nuk duhet ti jepet atij nga pamja fizike, por nga aftësia e tij intelektuale dhe profesionale.

Kështu profeti (a.s.) sahabiun e nderuar Bilal Habeshiun r.a. apo dhe sahabiun tjetër Abdullah ibn Ummu Mektumin r.a., ku njëri ishte ishte skllav dhe me origjinë afrikane, ndërsa tjetri ishte i verbër, ai do ti bënte pjesë të rëndësishme të shoqërisë Islame të asaj kohe, duke i bërë ata myezinët e parë në historinë Islame.

Ishin pikërisht këta dy sahabë që në dukje dhe aftësi fizike ishin ndryshe nga të tjerët, por ja që Muhamedi (a.s.) i vlerësoi për atë që ishin dhe në praktikë dha mesazhin universal që sot kemi nevojë të gjithë; **“Mos gjyko askënd nga pamja e jashtme, por vlerëso gjithësecilin për aftësitë e tij”**.

Profeti (a.s.) kësaj kategorie të njerëzve i dha vlerësimin maksimal, duke i bërë ata pjesë të shoqërisë.

Ai gjithashtu edukoi të tjerët që të dinë si të sillen me këta pjestarë të veçantë të shoqërisë, e kështu ai ngriti në piedestalin më të lartë rëndësinë e respektimit të qenies njerëzore për atë që është, sepse në realitet njeriu është krijesa më e bukur që ka krijuar Allahu (xh.sh.), ku vetëm kjo do të mjaftonte që termi i **bullizmit** të mos egzistonte në shoqërinë e sotme.

Kushdo që do të ndjekë këto parime, do të ketë bekimet e Allahut (xh.sh.) dhe do të jetë një ndjekës i vërtetë i rrugës profetike. Kushdo që është larg këtyre parimeve, por e shikon veten superior, ofendon dhe shan të tjerët, i bullizon për shkak të aftësive të ndryshme që ata njerëz posedojnë, do të ketë mbi veten mallkimin e Allahut (xh.sh.).

Kurrresi nuk është morale dhe etike të bullizosh dikë për një sprovë të tij, sepse në njëfarë mënyre kundërshton caktimin e Allahut (xh.sh.), dhe bie ndesh në sekretet dhe urtësitë e Zotit të Lartësuar.

DEVOTSHMËRIA

BUSULLA E BESIMTARIT

Devotshmëria, virtyti më i dashur për Allahun, ajo është busulla e orientimit të çdo besimtari. Në gjuhën arabe, shprehet me fjalën "takva", që rrjedh nga rrënja **ت-ق-و**, e cila do të thotë: të mbrosh, të ruash, të kujdesesh. Në aspektin terminologjik, takvaja nënkupton largimin nga veprimet e ndaluara dhe kryerjen e obligimeve për hir të Allahut.

Ajo është si një dritë e brendshme që ndriçon shpirtin e njeriut, duke i treguar besimtarit të largohet nga çdo e keqe që mund ta largojë atë prej mëshirës së Allahut. Njëkohësisht, është një forcë që e shtyn të ecë drejt çdo të mire që e afron me mëshirën, dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut. Takvaja nuk nënkupton vetëm qëndrimin larg të ndaluarave, por është një përkushtim i thellë për të jetuar me besim të pastër, me vigjilencë të vazhdueshme, me zell shpirtëror dhe me një zemër të lidhur fort pas besimit.

Takvaja është një vetëdije që ruan zemrën nga çdo formë e shirkut, madje edhe nga më të fshehtat e tij. Një përkufizim i thellë i takvasë është: të largohesh nga çdo gjë që cënon dashurinë dhe respektin ndaj Allahut. Ajo është një frikë që buron nga dashuria, frika se mos veprimet e tua e zbehin këtë dashuri, dhe shpresa se çdo hap i ndershëm të afron më shumë tek Allahu.

Gradët e takvasë

Në mendimin e dijetarëve, takvaja ka disa shkallë, por tri janë më të rëndësishmet:

Largimi nga veprimet e ndaluara. Kjo është grada e parë dhe themelore. Ajo simbolizon llogjikën, fillimin e ecjes shpirtërore. Besimtari e shmang gjynahin, duke e parë këtë si shenjë të besimit, respektit dhe dashurisë ndaj Krijuesit të Gjithësisë.

Largimi nga veprimet e dyshimta. Kjo është grada

e ndërgjegjes. Kur besimtari fiton qëndrueshmëri në shmangien e haramit, ai fillon të ruhet edhe nga ato që janë të paqarta. Edhe pse mund të jenë të lejuara në dukje, ai i shmang për të mos cënuar ndjeshmërinë ndaj Allahut.

Largimi nga veprimet e lejuara. Kjo është grada e shpirtit. Profeti Muhamed (s.a.s.) ka thënë: "Njeriu nuk do të arrijë të bëhet vërtet nga të devotshmit derisa të heqë dorë edhe nga gjëra që nuk janë gjynah, nga frika se mos ato e çojnë drejt gjynaheve". (Tirmidhiu, nr. 2451)

Një natë, Profeti Muhamed (s.a.s.) gjeti një kokërr hurme në shtëpinë e tij dhe e hëngri. Por menjëherë pas kësaj të mendtonte se mos ajo hurmë ishte prej sadakasë apo zekatit, të cilat janë të ndaluara për të. Ai nisi të qajë dhe t'i drejtohet Allahut me dua dhe istigfar, nga frika se mos kishte konsumuar diçka që nuk i lejohej. Në mëngjes, bashkëshortja e tij e pyeti për shqetësimin që kishte kaluar gjatë natës. Profeti (s.a.s.) iu përgjigj: "Hëngra një hurmë, por më pas u kujtova se në shtëpinë tonë vijnë sadaka dhe zekat. Mendova: si do t'i jap llogari Allahut për një gjë që më është ndaluar?" (Tirmidhi, sifatu'l-kijâme 19; Ibn Mâxhe, zuhd 24) Ky qëndrim i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) na mëson se devotshmëria e vërtetë nuk është thjesht largimi nga harami i dukshëm, por edhe ndjeshmëria ndaj dyshimit dhe frika që buron nga dashuria e sinqertë për Allahun. Ky është modeli më i lartë i takvasë të mos e ndotësh shpirtin as me hijen më të lehtë të gjynaheve dhe duke u përpjekur të jetosh gjithmonë nën hijen e kënaqësisë ndaj Allahut.

Ebu Bekri (r.a.) ka thënë: "Ne në kohën tonë largoheshim nga shtatëdhjetë dyer të lejuara, vetëm që të mos hapnim një derë të ndaluar". Umeri (r.a.) qante natën nga frika se mos kishte bërë padrejtësi. Osmani (r.a.) skuqej kur përmendej



xheneti nga turpi para mirësive të Allahut. Aliu (r.a) rrëqetëj në namaz.

Këto fjalë shpjegojnë ndjeshmërinë shpirtërore të sahabëve. Ata nuk e jetonin fenë vetëm si një bindje ndaj urdhrave dhe ndalesave, por si një përpjekje të vazhdueshme për të ruajtur afërsinë me Allahun. Ata shmangnin edhe gjërat e lejuara, nëse dyshonin se mund t'i çonin drejt diçkaje të ndaluar. Jetonin me një besim të pastër, me zemra të pastra dhe me frikë nga çdo gjë që mund të zbehte dashurinë me Allahun.

Takvaja; veshja e shpirtit

Takvaja nuk është thjesht një gjendje e brendshme, por një mënyrë e të jetuarit që lidh botën materiale me atë shpirtërore. Ajo e bën njeriun të veprojë me urtesi, zgjuarsia dhe ndjeshmëri duke zgjedhur më të mirën dhe më të drejtën në çdo situatë.

Imam Maliku transmeton se një burrë i kishte shkruajtur Abdullah ibn Zubejrit (r.a.) për vecoritë e të devotshmëve: "Të dish se njerëzit e devotshëm njihen nga këto cilësi: a) Pranojnë gjykimin edhe kur është kundra tyre, b) Falënderojnë Allahun për cdo mirësi, c) Bëjnë durim ndaj sprovave dhe nuk ankohen, d) Flasin të vërtetën, e) Kuranin e kanë udhërrëfyes të jetës së tyre.

Takvaja është një mburojë shpirtërore që e mbron besimtarin nga ndikimet e këqija. Ajo është një veshje e pastër që e mbulon, e mbron dhe e lartëson besimtarin. Besimtarin me takva nuk është i paprekshëm nga sprovat, por ai i përballon me durim. Ai nuk është i pastër nga gabimet, por pendimi i tij është i shpejtë dhe i sinqertë. Ai nuk është gjithmonë i fortë, por ai mbështetet gjithmonë tek Allahu.

Takvaja; porta e dashurisë së vërtetë

Rruga drejt takvasë është një udhëtim drejt zbulimeve të thellësive të shpirtit. Ajo nuk mund të përkufizohet vetëm me shmangien dhe largimin nga haramet, por kërkon edhe kujdes ndaj gjynaheve të vogla. Ato gjynahe që s'mund t'i shohin sytë, por që ndihen nga zemra. Madje edhe një fjalë e pakujdesshme, apo ndoshta një mendim i turbullt apo një veprim jo i sinqertë mund të trazojnë atë ndjeshmëri të brendshme që quhet takva.

Kjo gjendje e lartë e besimit nuk mund të arrihet pa dije, pa një përpjekje të vazhdueshme për të jetuar brenda rrethit të dispozitave të besimit dhe adhurimit. Kur besimtari arrin që në cdo veprim të mendojë vetëm për kënaqësinë e Allahut atëherë ai jeton me ndjenjën se është gjithmonë duke u pare nga Allahu dhe cdo veprim i tij merr një kuptim më të thellë dhe më të ndjeshëm. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: **"Më i miri prej prej jush tek Allahu është më i devotshmi midis jush." (Huxhurat, 49:13).**

Takvaja nuk është një frikë që e largon njeriun, por një dashuri që afron besimtarin me Allahun. Është një ndjenjë e zemrës që i tregon njeriut të kuptojë varfërinë dhe dobësinë e tij. Takvaja nuk është një stacion që arrihet, por një udhëtim që vazhdon përjetësisht. Ajo nuk është një gjendje shpirtërore e dhënë vetëm për dijetarët, por është një derë e hapur për çdo besimtar që kërkon të jetë i pastër dhe që dëshiron të gjendet afër me Allahun. Në një hadith kudsi Allahu thotë: **"E kur e dua njeriun, Unë bëhem dëgjimi me të cilin ai dëgjon, syri me të cilin ai shikon, dora me të cilën ai punon dhe këmba me të cilën ai ecën. Nëse më kërkon diçka, do t'ia jap, dhe nëse më kërkon mbrojtjen Time, do ta mbroj." (Hadith kudsi, Sahih al-Bukhari, nr. 6502)**

Parime Profetike në zgjidhjen e problemeve sociale



Njeriu është një qenie me natyrë sociale i cili ndërton jetën e tij në një mjedis shoqëror duke krijuar lidhje dhe marrëdhënie të ndryshme me të tjerët sipas një etike të caktuar që buron nga perceptimi i tij për jetën dhe qëllimi për të krijuar një shoqëri të shëndetshme. Të lidhura ngushtësisht me natyrën e njeriut dhe mjedisin shoqëror, këto marrëdhënie janë shpërfaqur përgjatë historisë për të ardhur deri në ditët e sotme. Kristalizmi dhe ndërlidhimi i tyre në kohë të ndryshme, veçanërisht në qytetërimin modern ka sjellë nevojën e njohurive të reja, ripërtëritjen e mendjes dhe shkencave të caktuara dhe ndërveprimeve të reja sociale dhe ekonomike në shoqërinë njerëzore.

Problemet dhe sfidat e ndryshme të modernitetit nuk kanë lënë pa prekur edhe botën myslimane. Kriza shpirtërore dhe intelektuale që ka shoqëruar myslimanët tre shekujt e fundit dhe shkëputja e Kuranit nga libri universit kanë pasuar me krizat dhe problemet sociale, ekonomike apo politike deri në ditët e sotme. Përballja me një qytetërim të ri dhe një jete të sekularizuar ka sjellë një krizë që ka rezultuar përgjithësisht me tëhuajësimin e vlerave dhe shkëputjen nga identiteti ashtu sikurse me lëvizje reaksionare të përkohshme që burojnë epistemologjikisht po nga i njëjti qytetërim. Kështu krahas njohjes së qytetërimit dhe botës në të cilën jetojmë është e rëndësishme të kthehemi në trashëgiminë tonë intelektuale dhe shpirtërore, për ta studiuar dhe medituar mbi të me imtësi për derivuar më pas parimet dhe metodologjinë për ti kapërcyer sfidat dhe problemet e ndryshme.

Profeti Muhamed a.s ishte njeriu i dimensioneve të larta që reflektonte në formën më pastër emrat Zotit, që kundërmonte gjithmonë flladët e përjetësisë në këtë jetë të përkohshme dhe si rrjedhojë ishte shembulli më i bukur i krijimit të një shoqërie të lumtur me të gjithë ekzistencat. Jeta e tij mbetet një model frymëzimi dhe një det i pafund për të zbuluar parimet e ndërtimit të një shoqërie sa më të mirë. Çdo mysliman i vetëdijshëm për natyrën e tij njerëzore, pozitën në univers dhe qëllimin e krijimit mund të ngrihet në gradën njerëzore vetëm pasi e shikon veten si një qenie shoqërore dhe me përgjegjësi të caktuar. Si rrjedhojë ai e shikon si pjesë një integrale të fesë një jetë ku është i dobishëm dhe jeton për të jetësuar të tjerët.

Dituria

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi gjithçka".

Lexo do të ishte Fjala e parë e Zotit në botën tonë njerëzore, urdhri i parë në Kuranin Famë'lartë. Dituria është udhërrëfyesi në errësirën e kësaj bote e cila kur ushqehet nga revelata hyjnore arrin

përmasa që i kapërcejnë tokë e qiej dhe merr një vlerë të veçantë. Nëpërmjet saj, çdo ekzistencë është një libër i shkruar që reflekton cilësitë e Zotit dhe e fton njeriun në rrugën e njohjes së Tij. Dituria është një shkallë e rëndësishme e besimit, një peshore thelbësore që ndan udhëzimin me herezinë, dyshimin me besimin e plotë. Ajo është një mister hyjnor që shfaq dimensionet e veçanta të qenies njerëzore. Dituria e vërtetë është për njeriun gjallëri e zemrës, dritë e arsyes, mësues i mendjes, lezeti e shpirtit dhe një dhuratë hyjnore e zbritur në tokë. Si rrjedhojë ajo e çon njeriun drejt mençurisë, kuptimit dhe vlerësimit të pozitës së tij si mëkëmbës në tokë. Ajo kthehet në një forcë shtytëse që njeriu të përpiket për ndërtimin dhe përmirësimin e jetës në tokë. Allahu i Lartësuar thotë: "Ai ju ka bërë mëkëmbës në tokë dhe ju ka ngritur në shkallë të ndryshme për t'ju vënë në provë me atë që ju ka dhënë".

Profeti Ynë i dashur i kushtoi një rëndësi parësore diturisë, edukimit të njerëzve që prej zhdukjes së analfabetizmit deri te kontributi për të krijuar një grup një njerëzish në shoqëri që do ti përkushtoheshin vetëm diturisë dhe mësimit. Të frymëzuar nga mësimet e tij shpirtërore dhe vizioni i tij myslimanët arritën të kuptonin në thellësi librin e Zotit pa e shkëputur nga libri i universit dhe do të hidhnin themelet e një qytetërimi të lavdishëm.

Vepra e mirë

"Allahu dëshiron që kur të bëni një punë, ta bëni siç duhet, domethënë, të plotë, të saktë e pa të metë!"

Parimi i dytë i cili i jep kuptim dhe vlerë diturisë është vepra e mirë. Ajo i jep jetë dhe ekzistencë diturisë përndryshe çdo dituri që nuk ka një projektion praktik, nuk frymëzon lëvizjen dhe ndryshimin për mire mbetet e destinuar të thahet e të mbarojë. Vetë Profeti Muhamed a.s ishte një Kuran që ecte mbi tokë, në mesin e njerëzve, ku Fjala e Zotit ishte bashkuar me tërë qenien e tij. Profeti ynë i edukoi sahabët e nderuar që të vepronin sipas asaj që dinin dhe të pastronin zemrat e tyre, për të ndërtuar identitetin e tyre dhe për të përmbushur përgjegjësitë fetare dhe ato në këtë botë.

Çdo njeri është një qenie me potenciale dhe aftësi të ndryshme. Dhe jete e çdo njeriu është një mision dhe një kuptim i veçantë në krijimin e Zotit. Kështu këto aftësi duhet të shpërfaqen nëpërmjet angazhimit, përpjekjes dhe vazhdimësisë në punën e mirë për të shpëtuar nga kotësitë, tundimet e shejtanit dhe për të falënderuar Zotin për këto mirësi duke qenë i dobishëm për të tjerët.

Profeti Muhamed a.s shprehet kështu në një

hadith: *"Njeriu i mençur duhet të vlerësojë mirë kohën në të cilën jeton, t'i përkushtohet punës së tij dhe ta ruajë gjuhën e tij. Kushdo që e konsideron fjalën si pjesë të veprës së tij, nuk flet më shumë sesa i nevojitet."* Ai i mësonte, mbështeste dhe ndihmonte të gjithë të angazhoheshin në punë dhe detyra të ndryshme sipas potencialeve dhe aftësive të tyre. Me gjenialitetin dhe zgjuarsinë profetike, ai do të arrinte zbulimin dhe vlerësimin e kapaciteteve njerëzore dhe edukimin e tyre për të qenë personalitete të larta dhe modele në të gjitha fushat e shoqërisë të cilët do të linin gjurmë në të gjithë historinë.

Ekulibri dhe Barazia

"Pa dyshim që prejardhja juaj nuk është shkak për t'u mburrur dhe përçmuar njëri tjetrin. Ju të gjithë jeni bijtë e Ademit dhe të gjithë jeni të barabartë."

Ekulibri dhe barazia është një nga parimet më të rëndësishme në jetën e një shoqërie. Në perspektivën islame të gjithë njerëzit janë të barabartë në krijim, e njeriut lartësohet te Zoti vetëm përmes devotshmërisë dhe veprave të mira. Koncepti i barazisë është i lidhur ngushtësisht me drejtësinë ku individët duhet të kenë të mundësi të barabarta që të mund të garantojnë të drejtat e tyre në një shoqëri në mënyrë që të jetojnë me dinjitet dhe kontribuojnë në shoqërinë në të cilën jetojnë. Në anën tjetër një nga parimet krijimit dhe natyrshmërisë njerëzore është edhe diversiteti ku çdo njeri ka cilësitë dhe karakteristika e tij të veçanta. Pra barazia nuk duhet të çojë në humbjen e këtij diversiteti duke mohuar personalitetin dhe identitetin e çdo njeriu. Kështu si shembull barazia mes burrave dhe grave nuk do të thotë që ata janë të njëjtë në çdo aspekt të natyrës apo detyrave që kanë, por barazia është në të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Një nga obligimet fetare dhe detyrat shoqërore gjithashtu është edhe bamirësia nëpërmjet zekatit, ose sadakasë apo veprave të tjera bamirëse në kontekstin e veprave vullnetare. Nëpërmjet këtij mekanizmi askush nuk mbetet pasdore. Si rrjedhojë në shoqëri sigurohet një balancë në nivelin ekonomik dhe shpërndarjen e pasurisë duke ngushtuar kështu humnerën midis shtresave të ndryshme të shoqërisë dhe në anën tjetër duke nxitur bashkëpunimin, komunikimin dhe dashurinë e harmoninë e midis njerëzve në një shoqëri.

Drejtësia

"Mos u ndani nga e drejta. E drejta ju çon në mirësi, kurse mirësia në xhenet."

Një nga virtytet kardinalë të qenies njerëzore

dhe parimet themelore e ekzistenciale për një shoqëri është drejtësia. Ajo është një virtyt që i mundëson njeriut largimin nga ekstremet dhe udhëheqjen e vetes së tij, ndjenjave, emocioneve dhe dëshirave drejt të mirës dhe të vërtetës. Në raport me enitetet e tjera, drejtësia është peshorja e cila i mundëson njeriut që çdo gjëje ti japë të drejtën e saj. Islami i ka kushtuar një rëndësi dhe kujdes të veçantë drejtësisë sociale, rëndësinë e përfaqësimit e të saj dhe brishtësinë e drejtësisë që çdo përgjegjës duhet të ketë kundrejt saj. Drejtësia është gjithashtu një element ekzistencial për jetën morale dhe një peshore për gjallërinë dhe jetëgjatësinë e një shoqërie.

Profeti Ynë na mëson të mbrojmë gjithmonë të drejtën dhe të ruhem nga padrejtësia e cila do të jetë errësirë për njeriun në botën e përtejme. Në një hadith Ai shprehet kështu: "Ky umet do të jetë në mirësi përderisa flet të vërtetën, gjykon me drejtësi dhe është i mëshirshëm kur i kërkohet mëshirë." Muhamedi a.s shembullin dhe edukimin e tij, krijoi modelin e një shoqërie të drejtë dhe ideale. Nën hijen e tij arriti të edukonte gjenialitete të tilla që pavarësisht fuqisë dhe suksesit, përulëshin plot frikë dhe përvuajtje para Zotit për përgjegjësitë dhe barrën e tyre dhe jetonin si njeriu më i thjeshtë në shoqërinë e tyre.

Mëshira dhe butësia

"Mëshiruesit i mëshironi Mëshiruesi. Mëshironi ata që janë në tokë, t'ju mëshirojë ai që është në qiell"

Mëshira është një nga virtytet më të larta dhe majave të smeraldëta të zemrës prej së cilës mund të rrjedhin shumë virtyte. punë të mira dhe shpërblime të pafundme në botën e përtejme. Ndërsa butësia është dantella ku duhet të kalojë çdo punë e mirë dhe çelësi për te zemrat e njerëzve të tjerë.

Zoti e pati dërguar Profetin Muhamed a.s si mëshirë për të gjithë botët. Mëshira e tij vazhdon të reflektojë mëshirën e Zotit si një burim në mesin e një shkretëtire të pafund ku njeriu i çdo epoke shuan etjen e tij. Dhe vetëm me anë të butësisë dhe mëshirës së tij njerëzit nuk u larguan, por u mblodhën rreth tij si fluturat rreth dritës dhe ngrohtësisë së zjarrit. Jeta e tij ishte mëshirë që përfshinte të gjithë njerëzit deri ta kafshët dhe bimët. Duke falur dhe treguar mëshirë edhe ndaj njerëzve që e luftuan dhe dëmtuan ai arriti të krijonte fron në zemrat e njerëzve për ti zbutur dhe marrë përdore drejt së Vërtetës dhe lumturisë së përjetshme

Të frymëzuar nga personaliteti i Profetit a.s, mendimet dhe jeta e tij, myslimanët e kanë

zbatuar praktikisht këtë ndjenjë të mëshirës në qytetërimin e tyre, duke themeluar institucione të shumta bamirësie. Kështu ata krijuan institucione në shërbim të edukimit, strehimit, kujdesit shëndetësor, mbështetjes së shtresave të ndryshme deri te ata që shërbenin për përkujdesjen ndaj kafshëve dhe shpendëve.

Zakonet dhe traditat

"Trego butësi dhe urdhëro për atë që është e njohur (e pranuar si e mirë)!"

Historia njerëzore është një mozaik i shpërfaqjes së emrave të Zotit dhe ligjeve të tij të krijimit në epoka dhe shoqëri të caktuara. Njeriu si bërthama e universit ka një lidhje ekzistenciale me të shkuarën dhe si rrjedhojë kultura, traditat dhe zakonet janë një dimension i rëndësishëm i formimit të shoqërisë dhe perceptimeve të saj.

Vetë Kur'ani Famëlartë është një libër universal, për të gjithë kohët dhe popujt por ai ka zbritur në "gjuhën" e njeriut të një kohe të caktuar. Një ndër fushat që duhet njohur në komentimin e Kuranit janë traditat e arabëve të kohës kur është zbritur Kur'ani në lidhje me fjalët, veprat apo zakonet e ndryshme. Në terminologjinë islame tradita (urf) përkufizon veprat të cilat feja dhe logjika e njeriut i konsideron të mira dhe gjithashtu arritjen në një konsensus mes njerëzve për t'u konsideruar të tilla. Gjithashtu në Jurisprudencën Islame tradita është një nga burimet e nxjerrjes së gjykimeve. Ajo shpreh një marrëveshje të caktuar të një shoqërie për një kohë relativisht të gjatë në lidhje me çështje të caktuara. Roli i traditës ndryshon në bazë të situatës. Ajo është një prej burimeve të gjykimit në bazë të së cilës ndryshojnë edhe gjykimet fetare.

Profeti Muhamed a.s ishte një udhërrëfyes dhe njohës i mirë i dinamikave shoqërore në mënyrën se si ai i vlerësoi traditat e shoqërisë në të cilën jetonte. Në këtë kontekst mund të shikohen qasje të ndryshme në lidhje me traditat si refuzimi, pranimi dhe përmirësimi. Traditat që binin krejtësisht në kundërshtim dhe parimet islame u refuzuan siç ishin disa lloje të martesave apo adhurimeve. Një pjesë e traditave u pranuan siç ishin traditat e shpërndarjes së ushqimit nga hashimitët për vizitorët e Qabes. Një pjesë e traditave u përmirësuan, duke u pastruar nga pjesa që binte në kundërshtim me parimet islame. Gjithashtu mund të shikohet që arabët përpara ardhjes së profetësisë kishin disa virtyte karakteristike për të cilat dalloheshin dhe përbënin themelet kryesore të organizimit shoqëror. Profeti Muhamed a.s arriti që virtytet e tilla dhe veprat që buronin prej tyre ti pastronte prej ekstremizmit, ti shkëputte nga ngjyrimet fisnore dhe ti purifikonte duke i qëndisur

nën parimet islame dhe duke i ngritur në lartësinë e virtyteve njerëzore.

Gradualiteti


"Lehtësoni dhe mos e vështirësoni! Përgëzoni dhe mos urreni!"

Njeriu është një qenie që ka ardhur në këtë botë me dobësinë dhe pafuqinë e tij e me nevojën e pafund për të mësuar, edukuar deri në arritjen e gradave më të larta. Kështu nëse Kurani dhe mësimet e tij erdhën për një periudhë njëzet e tre vjeçare në mënyrë graduale, edhe Profeti Muhamed a.s si përfaqësues i Tij dhe mësues i Fjalës së Zotit për njerëzimin ndoqi një metodë graduale më përcëlimin dhe përvetësimin e mësimave hyjnore të njerëzit. Kështu si në aspektin e urdhërësive fetare ashtu edhe në shërimin e plagëve sociale si skllavëria, apo tradita të caktuara ai ka ndjekur një rrugë graduale dhe të natyrshme deri në shërimin e tyre. Pasi që, ai nuk ishte dërguar si një engjëll apo një qenie me fuqi të veçanta për ndryshuar një shoqëri në një kohë të caktuar, por si një njeri i dimensioneve të veçanta, si një mësues dhe edukues për të treguar rrugën e dritës, shpëtimit dhe lumturisë për të gjithë njerëzinë.

Vlerësimi i rrethanave

Islami dhe mësimet e tij i drejtohen dhe janë në përputhje të plotë me natyrshmërinë e njeriut dhe të gjitha dimensionet e saj. Parimet e tij janë universale dhe të përbotshme që përfshijnë të gjithë njerëzit, shoqëritë dhe kulturat njerëzore. Kështu Profeti a.s në çdo çështje, merrte parasysh gjendjen e njerëzve në zbatimin e dispozitave fetare, në çështjet politike, ekonomike dhe ato shoqërore. Ai nuk i trajtonte të gjithë njësoj, por vlerësonte rrethanat e secilit dhe vepronte në përputhje me to. Sepse krahas parimeve të përgjithshme dhe të pandryshueshme të fesë, çdo njeri është një botë e veçantë që kërkon trajtimin sipas gjendjes së tij. Kështu Profeti a.s çdokujt i drejtohej sipas kapacitetit, potencialit, kulturës, statusit social, karakterit, personalitetit apo edhe gjendjes psikologjike të tij. Edhe në problemet sociale ai vlerësonte me kujdes natyrën e shoqërisë dhe kulturën e perceptimin e tyre për çështje të caktuara. Kështu, një ditë kur ai tregoi Hz.Aishes dëshirën e tij për ta rindërtuar Qaben mbi themelet e Ibrahimit a.s. pasi Kurejshët nuk e ndërtuan atë plotësisht sipas themeleve të para, i tha: *"O Aishe! Sikur populli yt të mos ishte i sapodalë nga idhujtaria, me siguri do ta shembja Qaben, do ta ktheja atë në nivelin e tokës dhe do t'i vendosja dy dyer"*

Stinët e jetës



Një burrë kish katër djem. Deshte t'u mësonte të mos i
gjykonin gjërat shpejt e shpejt, ndaj u tha të shkonin e të
shihnin një pemë shumë larg shtëpisë.

I madhi shkoi në dimër, i dyti në pranverë, i treti në verë dhe
më i vogli në vjeshtë.

Kur djemtë u kthyen në shtëpi i pyeti një nga një çfarë
kishin parë.

I madhi tha se kish parë një pemë të shëmtuar, të zhveshur
e të kërrusur.

I dyti se e kish parë plot sythe dhe bujisje.

I treti tha nuk ishte në një mendje me ta. Pema ishte plot me
lule, erëkëndshme dhe e bukur shumë... ishte gjëja më e bukur
që kish parë.

Me i vogli djalë kish një mendim krejt më tjetër... pema ishte
e ngarkuar me fruta dhe përplot jetë.

Babai u shpjegoi djemve se të katër kishin të drejtë, sepse e
kishin parë secili në një nga stinët e saj.

Ai u tha se nuk duhet ta gjykojnë as pemën, as njeriun
vetëm prej një stine të jetës së tij dhe se thelbi i njeriut që
është gëzimi, dashuria dhe gjithë çfarë arrin në jetë matet
vetëm në fund të stinëve të jetës.

Nëse dorëzohesh në dimër, humbet shpresën që dhuron
pranvera, bukurinë e beharit, arritjet e vjeshtës.

Mos lejo asnjëherë që dhimbja e një stine të shkatërrojë
atë që vjen më pas. Mos e gjyko jetën tënde në një stinë të
vështirë. Përballu e mbijeto në vështirësi, më e mira vjen pas.

Pse Zoti s'na pranon lutjet?

E keni njohur Allahun,
 Por s'iu keni përgjigjur
 Ftesës së Tij.
 Pohoni se e doni
 Pejgamberin e Zotit,
 Por ndaj sunneteve të Tij
 Tregoni mospërfillje.
 E këndon Kur'anin
 Dhe studioni,
 Por simbas Tij
 Nuk veproni.
 Jetoni duke u ushqyer
 Nga bekimet e Zotit,
 Por jeni mosmirënjohës.
 Thoni se shejtanin
 E keni armik,
 Por nuk e kundërshtoni
 Dhe nuk e luftoni.
 E pranoni se Xhenneti
 Vërtetë ekziston,
 Por nuk
 po punoni,
 Që atë ta meritoni.
 E besoni se Xhehennemi
 Vërtetë ekziston,
 Por nuk po përpiqeni
 Nga ai të shpëtoni.
 E dini se do të vdisni,
 Por për vdekje
 Nuk bëni përgatitje.nud
 Tërë ditën jeni të zënë
 Me marritë e të metat
 E të tjerëve,
 Por marritë e të metat tuaja
 Po i harroni.
 Të dashurit tuaj
 I keni varrosur,
 Dhe nga këto pësime
 Nuk keni marrë
 Aspak mësimë...!



